



UNIVERSITETI I TIRANËS



FAKULTETI I HISTORISË
DHE I FILOLOGJISË

STUDIME ALBANOLOGJIKE

1/2025



UNIVERSITETI I TIRANËS



FAKULTETI I HISTORISË
DHE I FILOLOGJISË

STUDIME ALBANOLOGJIKE

1 / 2025

Studime Albanologjike
1/2025

Botimi i parë 2025

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit

E-mail: studimealbanologjike@fhf.edu.alwww.studimealbanologjike.edu.al

© copyright Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës

ISSN 2305-3828

ISSN online 2959-9695

Drejtori

Prof. Dr. Mark MARKU

Kryeredaktori

Prof. Dr. Romeo HANXHARI

Bordi shkencor

Prof. Richard HODGES (University of East Anglia)

Prof. Alexander JOUX (Aix-Marseille Université)

Prof. asoc. Brunilda DASHI (Università di Roma “La Sapienza”)

Prof. asoc. Giusepina TURANO (Università Ca Foscari di Venezia)

Prof.as. Rigels HALILI (University of Warsaw)

PhD. Sonila TOMINI (UCL Global school for Health)

Prof. Dr. Valentina DUKA (Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Persida ASLLANI (Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Dhimitri BELLO (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Sonila XHAFA SINJARI (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Iris LUARASI (Universiteti i Tiranës)

Bordi editorial

Prof. Dr. Laura SMAQI (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Linda MËNIKU (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Alban TARTARI (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Enriketa PANDELEJMONI (Universiteti i Tiranës)

Prof. asoc. Dr. Esmeralda AGOLLI (Universiteti i Tiranës)

PhD. Edlira ÇARO (Universiteti i Tiranës)

PËRMBAJTJA / TABLE OF CONTENTS

Gjeografi - Geography

DIVERSIFIKIMI I BURIMEVE TË TË ARDHURAVE NË ZONAT RURALE: TRAJTESË KONCEPTUALE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË <i>DIVERSIFICATION OF INCOME SOURCES IN RURAL AREAS: A CONCEPTUAL APPROACH IN THE CONTEXT OF ALBANIA</i> Edlira Çaro (Kola), Ornela Hasrama, Ervis Krymbi.....	7
---	---

DY SHQIPËRI NË NJË KRYEQYTET: PABARAZITË SOCIO – EKONOMIKE MIDIS QENDRËS DHE PERIFERISË NË BASHKINË TIRANË <i>TWO ALBANIAS IN ONE CITY: SOCIO – ECONOMIC INEQUALITIES BETWEEN THE CENTER AND THE PERIPHERY IN THE MUNICIPALITY OF TIRANA</i> Ornela Hasrama, Edlira Çaro (Kola), Sokol Axhemi, Sonila Sinjari (Xhafa), Fisnik Mulgeci, Brunilda Shira	23
--	----

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI” <i>THE PRESERVATION OF BUILT AND ARCHAEOLOGICAL HERITAGE IN THE CONTEXT OF RAPID URBAN DEVELOPMENT. A CASE STUDY OF DURRËS</i> Marsida Gorea, Romeo Hanxhari.....	41
--	----

Histori – History

THE ALBANIAN QUESTION AND JAPAN: DIPLOMACY, INTELLIGENCE ACTIVITIES, AND PUBLIC OPINIONS (1912–1922) <i>ÇËSHTJA SHQIPTARE DHE JAPONIA: DIPLOMACIA, AKTIVITETET E INTELIGJENCËS DHE OPINIONE PUBLIKE (1912–1922)</i> Nakazawa Takuya.....	76
---	----

SHTETFORMIMI PËRMES ARSIMIT-ANALIZË KRITIKE E LIGJEVE ARSIMORE TË VITEVE 1921–1922 NË SHQIPËRI <i>STATE BUILDING THROUGH EDUCATION – A CRITICAL ANALYSIS OF THE EDUCATIONAL LAWS OF 1921–1922 IN ALBANIA</i> Valbona Nathanaili	89
--	----

Letërsi – Literature

GRUEJA SHQYPTARE - RËNDËSIA E BOTIMIT TË NJË REVISTE ME
FOKUS GRUAN

*ALBANIAN WOMAN – THE SIGNIFICANCE OF PUBLISHING A MAGAZINE
FOCUSED ON WOMEN*

Loreta Loli **102**

DIVERSIFIKIMI I BURIMEVE TË TË ARDHURAVE NË ZONAT RURALE: TRAJTESË KONCEPTUALE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

DIVERSIFICATION OF INCOME SOURCES IN RURAL AREAS: A CONCEPTUAL APPROACH IN THE CONTEXT OF ALBANIA

Dr. EDLIRA ÇARO (KOLA)

Universiteti i Tiranës

edlira.kola@unitir.edu.al

PhD. Cand. ORNELA HASRAMA

Universiteti i Tiranës

ornela.hasrama@unitir.edu.al

Dr. ERVIS KRYMBI

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

ervis.krymbi@unishk.edu.al

Abstract

Rural areas are undergoing a profound transformation toward a more diverse and flexible economic and social organization, where the diversification of income sources plays a central role. While agriculture remains important, it is no longer the main source of income and employment for many rural households, which are increasingly focusing on other activities such as agritourism, artisanal processing, and various services, often combined with professional and spatial mobility. This dynamic highlights the need to clarify the concept of rural diversification and to build a functional theoretical framework that can support the development of sustainable policies in the Albanian context. The methodology is based on an analysis of international scientific literature and a review of key concepts related to the diversification of the rural economy and income sources, focusing on theoretical and empirical developments that help understand this phenomenon in the Albanian reality. The findings show that rural diversification is a complex process that includes the expansion of both on-farm and off-farm activities, whether or not based on agricultural resources or the farm space. From the perspective of rural households, diversification appears not only as a survival tool in difficult conditions but also as a conscious strategy to increase economic resilience and flexibility. In the context of Albania's rural areas, where structural challenges are evident, the diversification of economic activities emerges as an

important dimension of rural transformation and the reconfiguration of residents' relationship with the territory.

Keywords: *diversification, rural areas, Albania, agriculture, rural economy, rural development, challenges*

Hyrje

Zonat rurale, në mbarë botën, po përjetojnë një proces intensiv diversifikimi dhe transformimi shumëdimensional, shpesh me ritme të përshpejtuara, që çojnë drejt formave të reja të organizimit ekonomik, social dhe hapësinor, si dhe në ndërtimin e modeleve të reja të zhvillimit lokal. Në të kaluarën, indi social-ekonomik i hapësirës rurale ishte i lidhur ngushtësisht me një lloj “besnikërie” apo edhe “kushtëzimi” ndaj karakteristikave natyrore të territorit, cikleve sezonale të prodhimit bujqësor, si dhe një mënyre dhe ritmi jetese të varur thellësisht nga veprimtaritë e fermës. Sot, ky realitet ka ndryshuar ndjeshëm. Edhe pse bujqësia vijon të jetë e pranishme dhe e rëndësishme në shumë zona rurale, ajo nuk është më sektori mbizotërues as për punësimin, as për të ardhurat e gjeneruara. Në shumë raste, për shkak të zhvillimeve teknologjike, automatizimit të prodhimit dhe digjitalizimit të praktikave bujqësore, por edhe për shkak të vështirësive për të përballuar konkurrencën në cilësi dhe sasi të produkteve, aktiviteti bujqësor ka kaluar në plan të dytë për shumë familje rurale.

Përballë këtij ndryshimi strukturor, familjet bujqësore po ndërmarrin strategji të reja jetese dhe mobiliteti për të siguruar burime të qëndrueshme dhe të diversifikuara të të ardhurave. Këto strategji shfaqen në mënyra të ndryshme. Disa familje zgjedhin të zhvillojnë më tej aktivitetin bujqësor, duke e pasuruar atë me funksione të reja, veçanërisht në sektorin e shërbimeve: nga tregtimi i drejtpërdrejtë i produkteve bujqësore, te zhvillimi i agroturizmit, edukimi në natyrë, përpunimi artizanal apo aktivitetet me bazë komunitare. Të tjera familje e rikrijonë profilin e tyre ekonomik duke u orientuar drejt veprimtarive jobujqësore që zhvillohen brenda kontekstit rural – të ashtuquajturat aktivitete “agri-rurale” – si sipërmarrje në turizëm, artizanat, prodhim për tregje të specializuara apo edhe shërbime për komunitetin. Një tjetër formë thelbësore diversifikimi është mobiliteti hapësinor dhe profesional i anëtarëve të familjes, veçanërisht i të rinjve. Shpesh ndodh që një ose më shumë pjesëtarë të familjes të punojnë jashtë fermës, madje jashtë zonës rurale, teksa lidhja me vendbanimin ruhet përmes remitancave, investimeve ose kthimeve sezonale. Këto transformime ndikojnë ndjeshëm në strukturën e ekonomisë rurale dhe në kompozimin e burimeve të të ardhurave për familjet. Ato nuk janë thjesht ekonomike, por përkthehen në ndryshime të thella sociale, kulturore dhe territoriale. Si rezultat, hapësira bashkëkohor rurale, larg së

DIVERSIFIKIMI I BURIMEVE TË TË ARDHURAVE NË ZONAT RURALE:
TRAJTESË KONCEPTUALE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

qeni thjesht një hapësirë prodhimi bujqësor, shfaqet gjithnjë e më shumë si një hapësirë shumëfunksionale, duke transformuar edhe mënyrën e jetesës së familjeve rurale. Ky evolucion ka transformuar territorin rural në një “arenë” dinamike, ku përplasen sfida të reja dhe krijohen mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, në varësi të kapaciteteve të aktorëve lokalë për të iniciuar, bashkëpunuar dhe përshtatur resurset ekzistuese me kërkesat e reja të shoqërisë.

Një realitet i tillë po bëhet gjithnjë e më i dukshëm edhe në Shqipëri. Zonat rurale të vendit, ndonëse përballen ende me sfida të mëdha si migrimi i brendshëm dhe jashtë vendit, fragmentimi i tokës, mungesa e infrastrukturës dhe një mbështetje e pamjaftueshme institucionale, po tregojnë shenja gjithnjë e më të qarta orientimi drejt diversifikimit të funksioneve dhe burimeve të të ardhurave. Agroturizmi është bërë një nga format më të prekshme të kësaj prirjeje, duke u kombinuar shpesh me promovimin e trashëgimisë kulturore dhe kulinare. Gjithashtu, një pjesë e fermerëve po zhvillojnë përpunimin artizanal të produkteve. Megjithatë këto iniciativa janë ende të fragmentuara dhe të përqendruara në disa zona më të aksesueshme ose të mbështetura nga projekte ndërkombëtare, ato përfaqësojnë një dinamikë të re rurale që synon të rikrijojë marrëdhënien e shoqërisë rurale me territorin në mënyrë më të qëndrueshme.

Pikërisht nga kjo dinamikë e re dhe komplekse që po përjetojnë zonat rurale shqiptare, lind nevoja për të sqaruar më tej konceptin e diversifikimit dhe për të ndërtuar një kuadër teorik e analitik më të qartë dhe funksional. Pa një kuptim të saktë të formave që merr diversifikimi, si dhe të faktorëve që e nxitin ose e frenojnë, orientimi strategjik i zhvillimit të zonave rurale bëhet i vështirë. Kjo nënkupton një domosdoshmëri për të thelluar studimin e literaturës ekzistuese mbi diversifikimin dhe koncepte të ndëlidhura me të. Vetëm përmes një baze të fortë njohurish teorike, të mbështetura edhe në përvoja praktike, mund të ndërtohen politika, instrumente dhe ndërhyrje të përshtatura që i përgjigjen realisht nevojave të transformimit rural në vendin tonë. Pikërisht këtë nevojë për një kuptim më të thelluar teorik mbi diversifikimin rural, të ndërthurur në mënyrë të vazhdueshme me referenca në kontekstin shqiptar, synon të trajtojë ky punim.

Metodologjia

Ky punim bazohet në një qasje teorike dhe analitike që synon të eksplorojë konceptin e diversifikimit dhe transformimit të ekonomive rurale si dhe të hapësirës rurale në tërësi. Si bazë kryesore metodologjike përdoret shfrytëzimi kritik i literaturës shkencore ekzistuese, e cila trajton zhvillimet teorike dhe empirike mbi diversifikimin në kontekste të ndryshme socio-hapësinore, me qëllim ndërtimin e një kuadri analitik të zbatueshëm në realitetin shqiptar. Në këtë kuadër, punimi strukturohet mbi disa pista kërkimore kryesore, nga të cilat burojnë edhe pyetjet kërkimore që e udhëheqin analizën: *Si ka evoluar koncepti i "diversifikimit" në literaturën shkencore dhe cilat janë kuptimet dhe nuancat që ai merr në kontekstin e veprimtarive ekonomike dhe burimeve të të ardhurave në zonat rurale? Cilët janë faktorët kryesorë që e shtyjnë ekonominë rurale drejt diversifikimit? A duhet parë diversifikimi si një instrument mbijetese në kushte të vështira ekonomike apo si një strategji afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të hapësirës rurale? Cilat janë elementët kyç që duhen marrë në konsideratë nga studiuesit, politikëbërësit dhe vendimmarrësit për të kuptuar dhe orientuar në mënyrë efektive procesin e diversifikimit të burimeve të të ardhurave në zonat rurale?* Kjo metodologji synon të krijojë një bazë të qartë dhe të mirëargumentuar për të shqyrtuar zhvillimet bashkëkohore në zonat rurale shqiptare, duke i vendosur ato përballë konceptualizimeve dhe përvojave të lidhura me diversifikimin ekonomik rural.

Gjetjet kryesore

Evolucioni i konceptit « diversifikim » dhe kontekstualizimi rural i tij

Termi “diversifikim” është i vështirë për t’u përcaktuar, madje edhe duke marrë parasysh vetëm aspektin etimologjik të tij. Fjala “diversifikim” rrjedh nga latinishtja, konkretisht nga folja “diversificare”, e cila në rrënjë ka fjalën “diversus”, në shqip “i ndryshëm”. Për ta zbërthyer dhe kuptuar më mirë, duke e lidhur me kontekstin ekonomik të veprimtarive, “diversifikim” do të ishte “ndryshim, duke i dhënë një ose disa forma të tjera”, “transformim”, “zgjerim aktiviteteve”. Çështja komplikohet kur bëhet fjalë për të përcaktuar këtë koncept nga këndvështrimi shkencor.

Përkundër realizimit të shumë studimeve që përpiqen të japin një kuptim sa më integrues, natyra komplekse e diversifikimit mbizotëron ende.

Përpjekjet për të dhënë një përkufizim të këtij fenomeni janë edhe më të vështira kur, si në rastin e këtij studimi, bëhet fjalë për të analizuar diversifikimin e burimeve të të ardhurave, që nënkupton një vëzhgim më të thellë me të gjitha implikimet sociale që ai ka.

DIVERSIFIKIMI I BURIMEVE TË TË ARDHURAVE NË ZONAT RURALE:
TRAJTESË KONCEPTUALE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

Në kuadër të kërkimeve mbi diversifikimin në përgjithësi, autorë të ndryshëm fokusohen në analizën e diversifikimit bujqësor, si një nga format e shprehjes së këtij fenomeni. Në këndvështrimin bujqësor, sipas Simon (2002, fq. 39), *“diversifikimi nënkupton një përshtatje përmes kërimit të vazhdueshëm dhe zbatimit të aktiviteteve të reja që sigurojnë zhvillimin e fermës, falë një burimi shtesë të të ardhurave”*. Gjithashtu, *“... duhet të bëhet dallimi mes diversifikimit të prodhimeve bujqësore, që është futja e prodhimeve të reja në sistemin e fermës, zbatimi i teknikave të reja të prodhimit dhe ndryshimet në sistemet klasike të prodhimit, dhe diversifikimit të ashtuquajtur ‘profesional’*. Ky i fundit nënkupton zgjerimin e fushës së veprimtarive të fermave përmes praktikimit të funksioneve të quajtura para-bujqësore, madje edhe jo bujqësore” (Simon, 2002, f. 41). Logjika e të njëjtit autor sugjeron njëkohësisht nevojën për të bërë dallimin midis diversifikimit sipas produktit, që përfshin përpunimin e dytë dhe/ose tregtimin e produkteve bujqësore, dhe diversifikimit të shërbimeve, që mund të jenë, për shembull, shërbime mikpritjeje në fermë.

Një analizë e ngjashme bëhet në një raport të ministrisë franceze të Bujqësisë dhe Peshkimit (2008), ku dallohen dy terma kyçë që ndihmojnë thellimin në konceptin e diversifikimit bujqësor:

- *diversifikimi bujqësor i pastër*, që përfshin kultivimin dhe blegtorinë jo konvencionale në zonën e konsideruar si rezultat i transpozicionit të një modeli ose zinxhiri prodhimi jashtë sektorit;
- *diversifikimi strukturor ose sipërmarrës*, që korrespondon me zhvillimin e aktiviteteve jo bujqësore bazuar në fermën dhe kryesisht të ushtruara nga bujku dhe familja e tij.

Sipas Matthews (2004, fq. 5), *“Diversifikimi brenda fermës (‘on-farm diversification’) i referohet përshtatjes së ndërmarrjeve bujqësore alternative ose jo konvencionale”*. Në të njëjtën kohë, autori tërheq vëmendjen mbi dikotominë që ekziston mes diversifikimit strukturor dhe atij bujqësor, duke përfshirë në të parin veprimtari të importuara nga jashtë fermës dhe në të dytin sipërmarrjet me fokus bujqësor. Po i njëjti autor thekson se konkurrueshmëria e sektorit bujqësor mbetet objektiv i rëndësishëm, por bujqësia e vetme e ka të pamundur të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme për zonat rurale. Sipas autorit, ruajtja dhe shtimi i punësimit në zonat rurale duhet kërkon krijim vendesh të reja pune në sektorin jo-bujqësor. Nëse e zhvendosim vëmendjen drejt zonave rurale të Shqipërisë, kjo nevojë rezulton edhe më e theksuar, në kushtet kur shumë komunitete rurale përballen me sfida të natyrës strukturore në bujqësi, të tilla si: parcelizimi i theksuar i tokës, deficitet në infrastrukturën bujqësore apo vështirësitë për të mbërritur në treg.

Autorë të tjerë, që kanë trajtuar tematikën e diversifikimit rural, e vendosin theksin në dallimin midis diversifikimit horizontal dhe atij vertikal, të

konsideruara si dy forma të ndryshme. Mehta (2009), duke u përqëndruar në diversifikimin e kulturave bujqësore (“crop diversification”) si një nga format bazë të diversifikimit ekonomik rural, vendos theksin në dallimin midis *diversifikimit horizontal të kulturave bujqësore*, si zgjerim i gamës së prodhimeve në sistemin bujqësor ekzistues, dhe *diversifikimit vertikal të kulturave*, si zgjerim brenda një zinxhiri prodhimi nëpërmjet sipërmarrjes. Sipas Pretini (2006, fq. 29), *“Diversifikimi i vetëm veprimtarisë së prodhimit mund të kuptohet në kuptimin horizontal, si zgjerim i gamës prodhuese, si dhe në kuptimin vertikal, si integrim i të gjitha fazave të procesit të krijimit të vlerës (nga furnizimi deri tek shitja)”*.

Por diversifikimi, edhe nëse marrim si pikë referimi fermerin apo familjen, në disa raste shfaq një dimension hapësinor që tejkalon kufijtë e fermës. Kështu, nëse një fermer angazhohet në një ose më shumë veprimtari jashtë fermës dhe produkteve/shërbimeve që ajo përfshin, mund të vërehet një formë më e gjerë diversifikimi që në këtë rast mund të konsiderohet si “diversifikim aktiviteteve” (Gondard-Delcroix, 2006). Duke iu rikthyer kontributit terminologjik të Mehta (2009), *“termi “diversifikim ekonomik” lidhet me prodhimin e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme në një fushë prodhimi dhe, në të njëjtën kohë, me realizimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike nga banorët e një hapësire gjeografike për të prodhuar një gamë më të gjerë mallrash dhe shërbimesh, që çon në të ardhura nga burime të ndryshme”*. Ky dimension i diversifikimit është thelbësor për ta kuptuar fenomenin jo vetëm si një zgjedhje individuale brenda fermës, por si një proces më i gjerë ekonomik e territorial, që ndikon dhe ndikohet nga dinamika strukturore të hapësirës rurale.

Strategjitë e diversifikimit të mjeteve të jetesës janë bërë një çështje me interes qendror për studiuesit e zhvillimit dhe hartuesit e politikave. (Kassegn dhe Abdinasir, 2023). Të shumtë janë studiuesit që e konsiderojnë diversifikimin e burimeve të të ardhurave si një faktor kyç në zhvillimin ekonomik të zonave rurale të vendeve në zhvillim, si dhe në zbutjen e varfërisë luan (e.g. Loison 2019). Duke ndjekur të njëjtën logjikë, Guri et al. (2009), duke iu referuar zonave rurale të Shqipërisë, theksojnë se zbatimi i strategjive alternative që shfrytëzojnë burime jokonvencionale përfaqëson një reagim të natyrshëm të fermave rurale përballë varfërisë. Diversifikimi i burimeve të të ardhurave, i mbështetur në mundësitë që ofron vetë ferma, është një alternativë që përmirëson gjendjen financiare të familjeve dhe kontribuon në “daljen” e tyre nga varfëria. Megjithatë, për arsye tashmë të njohura, fermat nuk janë gjithmonë mjaftueshëm të qëndrueshme financiarisht për të justifikuar investime në veprimtari prodhuese bujqësore ose në veprimtari jo të mirëfillta bujqësore, por të mbështetura në bujqësi apo plotësuese të saj (p.sh. përpunimi i qumështit, prodhimi dhe shitja e plehërave organikë, etj.). Për më tepër, edhe në rastet kur burimet e fermës shfrytëzohen, efektet financiare shpesh mbeten të kufizuara. Si rrjedhojë, alternativa më e pritshme bëhet angazhimi në veprimtari jobujqësore, në një spektër të gjerë

formash (sipërmarrje jashtë sektorit bujqësor, punë sezonale apo emigracion), gjë që redukton njëkohësisht varësinë nga bujqësia.

Një nga autorët që ka kontribuar veçanërisht në kërkimet mbi diversifikimin e burimeve të të ardhurave në zonat rurale është Frank Ellis. Në punimin e tij “Household strategies and rural livelihood diversification” (1998, fq. 1), jep një përkufizim kompleks të këtij koncepti si “*procesi përmes të cilit familjet rurale ndërtojnë një portofol të larmishëm aktiviteteve dhe mbështetje sociale për të mbijetuar dhe për të përmirësuar standardin e tyre të jetesës*”. Në një tjetër punim me vlerë, “The Determinants of Rural Livelihood Diversification in Developing Countries”, Ellis (2000, fq. 298), thekson se “*diversifikimi irrijton vëmendjen në mënyrë të qartë tek burime të ndryshme dhe të shumta të të ardhurave (bujqësore, jo bujqësore, remitanca, etj.) si karakteristikë kryesore*”. Kështu, koncepti i diversifikimit të burimeve të të ardhurave, që mund të shfaqet njëkohësisht si një strategji e ndërgjegjshme dhe si rezultat i kushteve socio-ekonomike, e zgjeron ndjeshëm kuptimin e vet. Ai shtrihet jo vetëm në larminë e aktiviteteve që ushtrohen, por edhe në dimensionin hapësinor ku ato zhvillohen, duke përfshirë si veprimtari brenda fermës, ashtu edhe ato jashtë saj.

Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale: Instrument mbijetese apo alternativë strategjike për zhvillim?

Përmbledhja e literaturës shkencore tregon se një numër i madh autorësh e lidhin fenomenin e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike dhe të burimeve të të ardhurave të familjeve rurale me nivelin e ulët të zhvillimit, duke përqendruar kërkimet e tyre në rajonet dhe vendet në zhvillim. Kjo vihet re në punimet e Reardon (1992); Reardon et al. (1992); Barrett et al. (2001); Abdulai dhe Crolerees (2001), etj. Nga këto studime kuptohet se nevoja për të ndjekur një strategji të tillë lind për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve “tradicionale”, siç është bujqësia, dhe është më e pranishme në popullsitë e këtyre territoreve ku strukturat ekonomike janë të brishta dhe të pambrojtura.

Megjithatë, siç vë në dukje Ellis (2000), përfshirja e familjeve bujqësore në aktivitete të shumta nuk është as e re dhe as e kufizuar vetëm në zonat rurale të vendeve në zhvillim. Sipas tij, diversifikimi i burimeve të të ardhurave është një dukuri e përhapur dhe e pranishme në të gjitha kontekstet gjeografike, në ferma të madhësive të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të pasurisë dhe të ardhurave. Ky vëzhgim tregon se diversifikimi nuk është thjesht një përgjigje ndaj varfërisë, por edhe një strategji e zakonshme për të rritur stabilitetin dhe fleksibilitetin ekonomik të familjeve.

Përkundër kësaj përhapjeje gjeografike, lind pyetja se cilat janë arsyet që shtojnë individët apo familjet e zonave rurale drejt diversifikimit? Nga hulumtimi bibliografik rezulton se faktorët janë kryesisht ekonomikë. Për shembull, Lavoie

(2006), vendos theksin te zvogëlimi i varësisë financiare të ndërmarrjes nga një burim i vetëm. Pra, diversifikimi shihet si një mjet për të zvogëluar rrezikun financiar përmes shpërndarjes së burimeve dhe të ardhurave. Por, nuk duhet konsideruar që motivimi për diversifikim ka vetëm natyrë ekonomike. Literatura tregon qartë se qëllimet dhe motivet që nxitin diversifikimin ndryshojnë në varësi të fushës ku ndodh ky proces. Për shembull, sipas De Myttenaere (2005), kërkimi për një identitet profesional dhe social nga ana e grave që punojnë në bujqësi, si dhe hapja e një hapësire të re jetese, janë dy faktorë thelbësorë në kuptimin e arsyeve të diversifikimit bujqësor në drejtim të turizmit rural. Kjo tregon se motivet sociale, kulturore dhe personale mund të jenë po aq të vlefshme sa ato ekonomike.

Sipas F. Ellis (2000), motivet e individëve dhe familjeve për të ndjekur një strategji diversifikimi mund të ndahen në dy kategori kryesore: *nevoja* dhe *zgjedhja*. Nevoja përfaqëson arsyet e detyruara, të lidhura me mungesën e burimeve, pra ka një konotacion kufizues apo negativ, ndërsa zgjedhja lidhet me vullnetin, pra ka ngjyrim pozitiv. Realiteti, siç vërehet edhe në rastin e familjeve dhe zonave rurale të Shqipërisë, tregon se këto dy arsye nuk janë të ndara në mënyrë të prerë, por shpesh shfaqen të ndërthurura. Kështu, ndonëse një familje rurale mund të ketë si pikënisje të diversifikimit ekonomik nevojën për të shtuar burimet e të ardhurave të saj dhe, për rrjedhojë, për t'i rritur këto të ardhura, natyra e veprimtarisë drejt së cilës do të orientohet apo resurset në të cilat do të mbështetet për veprimtarinë e re, është pjesë e zgjedhjes së saj. Diversifikimi, pavarësisht faktorëve themelorë që e shtyjnë atë (të jashtëm apo të brendshëm, globalë apo lokalë, individualë apo familjarë), përfaqëson, në thelb, një nevojë që mund të jetë ekonomike, sociale, kulturore apo edhe shpirtërore. Kjo do të thotë që motivet për diversifikim janë të shumëfishta dhe rrjedhin nga kontekste të ndryshme që ndikojnë në jetën e përditshme të individëve ruralë.

Duke u fokusuar në faktorët që motivojnë familjet të orientohen drejt ushtrimit të aktiviteteve jobuqësore në zonat rurale, Reardon et al. (1998) i ndajnë këta faktorë në dy kategori, konkretisht: *a) faktorë tërheqës*, të tillë si të ardhurat më të kënaqshme që mundëson ushtrimi i aktiviteteve në sektorë jobuqësorë ; *b) faktorë shtytës*, si për shembull performanca e dobët e një ferme si rrjedhojë e ngjarjeve apo problemeve, të përkohshme ose afatgjata, pasiguria në tregjet bujqësore, etj. Edhe pse këta faktorë zakonisht identifikohen në mënyrë empirike, është thelbësore të merret në konsideratë ndërveprimi i tyre i ndërsjellë. Siç vërejnë Dimova dhe Sen (2010), prania e faktorëve shtytës mund të nxisë zhvillimin apo aktivizimin e faktorëve tërheqës. Për shembull, nivelet e ulëta të të ardhurave nga bujqësia (faktor shtytës) mund të nxisin individët të orientohen drejt alternativave më të leverdishme në sektorë të tjerë ekonomikë (faktorë tërheqës).

Një qasje tjetër dualiste mbi motivimet për diversifikim paraqitet nga Henke dhe Salvioni (2010), të cilët këmbëngulin se motivimi i fortë për diversifikim dhe zgjerim të aktiviteteve në bujqësi është rezultat i një vetëdijeje të re mbi kompleksitetin dhe vlerësimin e shumëfunksionalitetin e sektorit rural. Duke pikënisur nga konstatimet e këtyre autorëve, arugmentet që mund të jepen janë të shumta. Nga ana tjetër, banorët kërkesat e banorëve të zonave urbane në raport me atë çfarë ofrojnë zonat rurale ka ndryshuar thelbësisht. Zonat rurale nuk konsiderohen më vetëm si furnizuese të prodhimeve bujqësore, pra si garantuese të bazës ushqimore për popullsinë urbane, por edhe si ofruese shërbimesh të ndryshme me natyrë sociale dhe kulturore, bazuar në shfrytëzimin dhe valorizimin e mjedisit dhe peizazheve, traditave dhe produkteve jobujqësore rurale. Nga ana tjetër, gjithnjë e më të ndërgjegjësuar mbi llojshmërinë e resurseve dhe funksioneve të zonave rurale, mbi efektin tërheqës që kanë tek popullsia urbane, por njëkohësisht edhe të udhëhequr nga shembuj të suksesshëm përreth, vetë banorët e këtyre zonave po identifikojnë dhe përshtatin resurset e tyre lokale, nëpërmjet nismave individuale, por edhe kolektive, për t'ë diversifikuar aktivitetet që zhvillojnë. Përpos këtyre faktorëve, politikat dhe strategjitë e zhvillimit (si ato në nivel qendror, edhe në nivel lokal) po nxitin vazhdimisht, nëpërmjet skemave të ndryshme të mbështetjes financiare dhe jo vetëm (p.sh. kualifikim i kapitalit njerëzor), këtë proces të diversifikimit të ekonomisë rurale, duke mundësuar gjenerim vendesh pune dhe të ardhurash edhe përtej sektorit bujqësor.

Sidoqoftë, pavarësisht nevojës së brendshme të familjeve rurale për të diversifikuar aktivitetet (që përkthehet në shtim të të ardhurave) apo efektit tërheqës që mund të kenë disa aktivitete ekonomike jashtë sferës së ngushtë të prodhimit bujqësor, strategjitë për diversifikimin e të ardhurave zhvillohen brenda mundësive dhe burimeve që ato zotërojnë dhe janë ngushtësisht të lidhura me karakteristikat e vetë familjes rurale. Sipas literaturës ekzistuese, konstatimi i Sourisseau et al. (2012), sipas të cilëve format e organizimit të ekonomive bujqësore familjare evoluojnë në kohë në varësi të kontekstit ku ndodhen, përforcohet më tej nga argumentet e Briet dhe Gastineau (2006), të cilët theksojnë se këto strategji janë gjerësisht të varura nga karakteristikat e brendshme të familjes (si kapitali njerëzor dhe ekonomik), por edhe nga konteksti lokal socio-ekonomik, përfshirë tregun e punës, mundësitë për migrim, etj.

Në kontekstin e zonave rurale shqiptare, ku trashëgimia socio-ekonomike, fragmentimi i tokës, mundësitë e kufizuara për punësim dhe migrimi masiv kanë krijuar realitete të ndryshme ndërmjet rajoneve, analizimi i detajuar i karakteristikave të familjeve rurale bëhet i domosdoshëm. Që prej viteve '90, dhe veçanërisht gjatë dekadës së fundit, vërehet një tendencë jo vetëm drejt intensifikimit apo zgjerimit të aktivitetit bujqësor, por edhe drejt shtimit të veprimtarive plotësuese. Këto shfaqen përmes kalimit nga prodhimi për

vetëkonsum drejt prodhimit të orientuar nga tregu, duke treguar një fleksibilitet në përshtatjen e prodhimit me kërkesën e konsumatorit dhe duke intensifikuar vazhdimisht procesin e tregtimit (si përmes zgjerimit të zonës së shitjes apo rritjes së larmisë së produkteve). Gjithashtu, vihet re hapja e punishteve të vogla dhe ndërmarrjeve për përpunimin e produkteve bujqësore, si dhe angazhimi në veprimtari të natyrës agroturistike. Një kuptim më i thellë i strategjive të tyre të mbijetesës, burimeve që disponojnë dhe pengesave me të cilat përballen përbën bazën për ndërtimin e politikave zhvillimore më të personalizuar dhe më të efektshme. Nxitja e diversifikimit nuk mund të mbështetet vetëm në modele të përgjithshme apo të huazuara, por kërkon një përshtatje të kujdesshme me nevojat konkrete të komuniteteve rurale të vendit, duke reflektuar dallimet ndërmjet zonave sipas veçorive të tyre natyrore, traditave në veprimtari ekonomike, organizimit social dhe aftësisë për t'u përshtatur me ndryshimet.


Pavarësisht përpjekjeve për të përcaktuar në mënyrë të qartë thelbin e diversifikimit ekonomik apo të burimeve të të ardhurave, ky term mbart një sërë kuptimesh dhe nuancash të shumta. Ai varion nga konceptimi i diversifikimit si një “mjet mbijetese për komunitetet rurale” (Lavoie, 2006, fq. 3), apo si një “strategji jetese” (livelihood strategy) (Ellis, 2000, fq. 291), deri te përkufizimi si një “strategji zhvillimi që konsiston në larmimin ose zgjerimin e gamës së produkteve dhe të klientelës, për të mundësuar zhvillimin ose për t'u mbrojtur nga pasiguria në bujqësi përmes një burimi plotësues të të ardhurave” (De Myttenaere, 2005, fq. 33). Edhe pse procesi i diversifikimit shpesh buron nga zgjedhjet e një individi apo familjeje për të riorganizuar aktivitetet ekzistuese apo për të hyrë në veprimtari të reja, kryesisht për arsye ekonomike, por gjithashtu për arsye sociale apo kulturore, funksioni i tij shkon përtej nivelit mikro. Diversifikimi nuk është vetëm një mekanizëm për të përmbushur nevojat bazë të individit apo familjes, por ka një ndikim më të gjerë: ai përfaqëson një strategji për rritjen e të ardhurave lokale, krijimin e vendeve të reja të punës, konsolidimin e aktiviteteve ekzistuese dhe vënien në vlerë të burimeve territoriale. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se diversifikimi përmban potencial zhvillimor dhe karakteristika pozitive që mund të kompensojnë konotacionet e mundshme negative që ndonjëherë i atribuohen këtij fenomeni (Ellis, 2000).

Sintezë konstatimesh mbi diversifikimin e burimeve të të ardhurave në zonat rurale të Shqipërisë

Sektori bujqësor në Shqipëri, i cili konsiderohet si sektori primar për zonat rurale, është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së vendit, duke kontribuar me 19% në PBB dhe duke punësuar rreth 1/3 e fuqisë punëtore (përqindja më e lartë në Ballkanin Perëndimor). Në 15 vitet e fundit, shifra e vlerës së shtuar bruto për produktet bujqësore është më shumë se dyfishuar, duke treguar një zhvillim pozitiv të sektorit (FAO, 2023). Në Shqipëri, diversifikimi është veçanërisht i rëndësishëm, por edhe sfidues për t'u arritur, për shkak të fragmentimit të tokës dhe mungesës së mundësive të tjera ekonomike në zonat rurale. Sipas studimit të FAO-s, zhvillimi i agroturizmit dhe i zinxhirëve të tjerë të ekonomisë bujqësore janë identifikuar si motorrë zhvillimi për zonat rurale të qëndrueshme.


Nisur nga shqyrtimi i literaturës mbi diversifikimin ekonomik dhe nga njohja e realitetit të zonave rurale të Shqipërisë, ka disa pika kyçe që duhet të merren në konsideratë kur flitet për nxitje të zhvillimit të zonave rurale nëpërmjet diversifikimit ekonomik. Diversifikimi nuk është thjesht një mjet mbijetese, por duhet të kuptohet si strategji zhvillimi afatgjatë që kontribuon në qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të zonave rurale. Diversifikimi i të ardhurave në zonat rurale përfshin zgjerimin e burimeve të të ardhurave përtej bujqësisë tradicionale, duke përfshirë aktivitete si agroturizmi, përpunimi i produkteve bujqësore, artizanati dhe shërbimet. Nëse do t'i referoheshim kategorive të diversifikimit të të ardhurave që gjenerohen në një zonë rurale, përmendim ndërthurjen e degëve të ndryshme të ekonomisë që mund të përfshihen në sektorin bujqësor ose jo.

Skema 1. Kategoritë e Diversifikimit



Literatura thekson se, përtej perceptimit konvencional që e lidh zhvillimin rural ngushtësisht me bujqësinë, zonat rurale janë hapësira me potenciale shumëdimensionale, ku të ardhurat mund të gjenerohen nga aktivitete të ndryshme jo-bujqësore, përfshirë turizmin rural, artizanatin, agropërpunimin, apo shërbimet e vogla lokale. Kjo kërkon një rikonceptualizim të rolit të fshatit dhe një zhvendosje nga politikat e mbështetjes vetëm për fermerët drejt mbështetjes së gjithë banorëve të zonave rurale. Nga ana tjetër, nuk ka një model të vetëm të diversifikimit ekonomik, që t'i përshtatet njëlloj të gjitha territoreve rurale. Në rastin e Shqipërisë, mund të përmendim orientimin e zhvillimit të zonave rurale, të cilat identifikohen për një produkt apo shërbim të caktuar, por që ndërthuren mjaft mirë edhe me zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë bujqësore, duke diversifikuar të ardhurat e popullsisë lokale. Për shembull, zona e Zadrimeës është e njohur për artizanatin, por e ndërthur mjaft mirë këtë aktivitet ekonomik me prodhimin e verërave; Divjaka njihet për agroturizmin, por e ndërthur mjaft mirë edhe me turizmin e natyrës; Gjirokastra veçohet për turizmin kulturor rural, por e ndërthur këtë aktivitet edhe me degë të tjera ekonomike. Ndaj, disa prej formateve më të zakonshme të diversifikimit të të ardhurave, në zonat rurale, në Shqipëri evidentojmë raste si të agroturizmit, përpunimit të produkteve vendore, apo artizanatit.

Skema 2. Formatet e diversifikimit të të ardhurave në zonat rurale në Shqipëri



Burimi: Ilustrim i autorëve

Megjithatë, nëse do të bënim një analizë të faktorëve që ndikojnë në diversifikimin e të ardhurave, do të evidentonim faktorët individualë dhe ata kontekstualë. Në Shqipëri, faktorët që ndikojnë në diversifikimin e burimeve të të ardhurave në zonat rurale janë të shumtë dhe ndërveprojnë në mënyrë të ndërlidhur. Në nivel individual, karakteristikat si: mosha, niveli i arsimit, përvoja në bujqësi dhe gjinia luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e aftësisë së individëve për të eksploruar dhe zhvilluar aktivitete alternative ekonomike. Për shembull, gratë shpesh përballen me kufizime në qasje ndaj burimeve dhe informacionit, gjë që ndikon negativisht në mundësitë e tyre për diversifikim. Në

nivel kontekstual, faktorë si: infrastruktura (rrjeti rrugor, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, interneti), afërsia me tregjet urbane, ekzistenca e institucioneve mbështetëse (kooperativa, OJQ, bashki), dhe politikat publike (subvencionet, programet e zhvillimit rural) janë përcaktues në zhvillimin e mëtejshëm të zonave rurale. Sipas FAO-s (2018), mungesa e investimeve në infrastrukturën rurale dhe mungesa e fuqisë punëtore të re janë ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e ekonomive të diversifikuara në këto zona, duke e bërë të nevojshme ndërhyrjen me politika të targetuara për të mbështetur aktorët ruralë në këtë drejtim. Prandaj, diversifikimi në Shqipëri nuk mund të kuptohet si një proces individual i izoluar, por si rezultat i një ndërthurjeje faktorësh strukturorë dhe socio – demografikë.

Përveç faktorëve të përmendur, të cilët kanë një peshë shumë të rëndësishme në zhvillimin territorial, është e nevojshme që të adresohen edhe sfidat me të cilat përballen zonat rurale. Nevoja për të forcuar sigurinë ushqimore, për t'i shtuar vlerë produkteve primare dhe për të përmirësuar koordinimin e zinxhirëve të vlerës ushqimore mbeten problematika për t'u adresuar në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe t'i përgjigjet kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, të qëndrueshëm, si dhe për t'u harmonizuar me standardet e sigurisë ushqimore të BE-së. Nga ana tjetër, përmendim sfidat mjedisore, të tilla si: ndryshimi i klimës, ndotja e ujit dhe ajrit, degradimi i tokës (FAO, 2023), fragmentimi i tokës bujqësore, qasja e kufizuar në financa/mikrokredi, emigrimi dhe plakja e popullsisë rurale, mungesa e infrastrukturës digjitale dhe fizike, apo edhe politika të pasigurta ose mungesë e mbështetjes afatgjatë, të cilat paraqesin kërcënime të konsiderueshme për sektorin primar të zonave rurale. Ndërkohë, politikat zhvillimore që nxitin diversifikimin rural, duhet medoemos të marrin parasysh elemente si: specifikat lokale, kapacitetet ekzistuese njerëzore, traditat në veprimtari ekonomike, etj. Gjithashtu, nevojitet një qasje e integruar politike, që bashkon bujqësinë me sektorë të tjerë si: turizmi rural, artizanati apo shërbime të tjera që mbështeten direkt ose indirekt në resurse lokale.

Përfundime

Struktura ekonomike e hapësirave rurale dhe e familjeve rurale po bëhet gjithnjë e më e larmishme, duke përfshirë shpesh, brenda një familjeje, një gamë të gjerë aktiviteteve dhe formash angazhimi. Studiuesit dallojnë forma të ndryshme të diversifikimit, që nga diversifikimi bujqësor (nëpërmjet produkteve ose shërbimeve, horizontal ose vertikal, thjesht bujqësor ose sipërmarrës/strukturor), i cili bazohet në shfrytëzimin e burimeve të fermës, e deri te diversifikimi i aktiviteteve ekonomike, që nënkupton zgjerimin e gamës së aktiviteteve të familjes. Kjo e fundit përfshin aktivitete ose forma të tjera angazhimi që nuk bazohen në burimet e fermës, duke përfshirë edhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave, si në rastin e përfshirjes së remitancave

migratore. Literatura ndërkombëtare na orienton për të kuptuar më mirë se çfarë duhet të merret në konsideratë kur flitet për nxitje të diversifikimit të zonave rurale të vendit. Në Shqipëri, fokusimi në diversifikimin e ekonomive rurale shtron nevojën e një narrative të re, që i sheh ato jo vetëm si hapësira bujqësore, por si vende me burime natyrore, kapital njerëzor dhe mundësi të shumta për një shumëllojshmëri aktiviteteve ekonomike, të cilat ruajnë dhe i shtojnë vlerë fermës, produkteve dhe shërbimeve tradicionale, por gjithashtu zgjerohen në pista të reja, përtej fermës dhe resurseve bujqësore, për të krijuar më shumë punësim, të ardhura dhe mirëqenie. Të gjitha këto vlerësime duhet të jetë në themel të politikave dhe strategjive zhvillimore, si dhe të orientojë kërkimin shkencor në vend. Ndaj, edhe orientimet për të ardhmen duhet të fokusohen në forcimin e kapaciteteve lokale (trajnim, edukim rural), mbështetjen për sipërmarrje të vogla ose start-upe rurale, nxitjen e bashkëpunimit rural-urban dhe modelet e zhvillimit të integruar territorial, politikat që nxitin kthimin e emigrantëve me kapital dhe ide për investim në zonat rurale, si dhe ndërthurjen e degëve të ndryshme të ekonomisë, që sigurojnë të ardhura përgjatë gjithë vitit për të mbuluar të ardhurat sezonale, shpesh modeste, të familjeve në zonat rurale.

Literatura

1. Abdulai, Awudu, and Anna Crolerees. "Determinants of Income Diversification amongst Rural Households in Southern Mali." *Food Policy* 26 (2001): 437–452.
2. Barrett, Christopher B., Thomas Reardon, and Patrick Webb. "Nonfarm Income Diversification and Household Livelihood Strategies in Rural Africa: Concepts, Dynamics and Policy Implications." *Food Policy* 26 (2001): 315–331.
3. Briet, Anne-Pascaline, and Bénédicte Gastineau. "Les migrations de travail dans les stratégies de diversification des revenus dans le milieu rural malgache. Étude de la commune d'Ampitatafika." In *Population et travail, dynamique démographique et travail. Actes du colloque d'AIDELF*, 721–733, 2006.
4. De Myttenaere, Bernard. "Dynamiques de diversification agricole et tourisme en espace rural wallon : regard sur la place des agriculteurs." Paper presented at *Colloque FAIRE CAMPAGNE*, UMR 6590-ESO, Rennes, March 17–18, 2005, 31–45.
5. Dimova, Ralitza, and Kunal Sen. *Is Household Income Diversification a Means of Survival or a Means of Accumulation? Panel Data Evidence from Tanzania*. Working Paper 122. Manchester: Brooks World Poverty Institute, 2010.

6. Ellis, Frank. "Household Strategies and Rural Livelihood Diversification." *Journal of Development Studies* 35, no. 1 (1998): 1–38.
7. ———. "The Determinants of Rural Livelihood Diversification in Developing Countries." *Journal of Agricultural Economics* 51, no. 2 (2000): 298–302.
8. FAO. 2023. "FAO Partners with Albania for Sustainable and Resilient Agrifood Systems and Rural Development." <https://www.fao.org/europe/news/detail/fao-albania-partner-for-sustainable-and-resilient-agrifood-systems-and-rural-development/en>.
9. Gondard-Delacroix, Claire. "Diversification des activités et dynamiques de pauvreté en milieu rural malgache, entre gestion des risques et barrières à l'entrée." Paper presented at *Septièmes journées du réseau Analyse Économique et Développement de l'Agence Universitaire de la Francophonie (AUF)*, Paris, September 7–8, 2006.
10. Guri, Fatmir, Etleva Dashi, and Jolia Korita. "Diversifikimi i aktiviteteve në zonat rurale, një mundësi për reduktimin e varfërisë." *Ekonomia dhe agrobiznesi*, no. 1 (2009): 201–211.
11. Henke, Roberto, and Cristina Salvioni. "La diversificazione del reddito nelle aziende agricole italiane: una via di uscita dalla crisi?" Paper presented at *XLVII Convegno SIDEA*, September 2010.
12. Kassegn, A., and Abdinasir U. "Determinants of Rural Households' Livelihood Diversification Strategies: In the Case of North Wollo Zone, Amhara National Regional State, Ethiopia." *Cogent Economics & Finance* 11, no. 1 (2023). <https://doi.org/10.1080/23322039.2023.2185347>.
13. Lavoie, Eric A. "La diversification... une stratégie d'entreprise!" Paper presented at *Colloque de l'entrepreneur gestionnaire « Et si on gérait autrement »*, Drummondville, November 23, 2006.
14. Loison, S. A. "Household Livelihood Diversification and Gender: Panel Evidence from Rural Kenya." *Journal of Rural Studies* 69 (2019): 156–172. <https://doi.org/10.1016/j.jrurstud.2019.03.001>.
15. Matthews, Alan. "On and Off Farm Diversification: The Policy Framework." Paper presented at *Policy Workshops on Rural Development*, Curragh, February 25, 2004.
16. Mehta, Rajiv. "Rural Livelihood Diversification and Its Measurement Issues: Focus India." Paper presented at *WYE City Group on Statistics on Rural Development and Agriculture Household Income*, Rome, Italy, June 11–12, 2009.
17. Ministère de l'Agriculture et de la Pêche. *La diversification et la valorisation des activités agricoles au travers des services participant au*

- développement rural. Eléments de réflexion, scénarios d'organisation, propositions.* Report presented by Frédéric Nihous. 2008.
18. Pretini, Nicoletta. *Diversificazione e multifunzionalità in agricoltura. Una analisi per le Marche.* Associazione Alessandro Bartola, Studi e ricerche di economia e di politica agraria, Collana Tesi on-line, no. 14, 2006.
 19. Reardon, Thomas, Christopher Delgado, and Peter Matlon. "Determinants and Effects of Income Diversification amongst Farm Households in Burkina Faso." *Journal of Development Studies* 32 (1992): 899–912.
 20. Reardon, Thomas. "Income Diversification of Rural Households in the Sahel." *Rural Development Studies* 24 (1992): 281–297.
 21. Schenck, Laura. 2018. *Small Family Farming in Albania – A Country Specific Outlook.* FAO.
<https://openknowledge.fao.org/server/api/core/bitstreams/70ace099-fd0d-4ac0-843a-f435204551fd/content>.
 22. Simon, Anthony. *La pluriactivité dans l'agriculture des montagnes françaises. Un territoire, des hommes, une pratique.* Clermont-Ferrand: CERAMAC 19, Presses Universitaires Blaise Pascal, 2002.
 23. Sourisseau, Jean-Michel, Pierre-Marie Bosc, Sandrine Fréguin-Gresh, et al. "Les modèles familiaux de production agricole en question (Comprendre leur diversité et leur fonctionnement)." *Autrepart* 3, no. 62 (2012): 159–181.

**DY SHQIPËRI NË NJË KRYEQYTET: PABARAZITË SOCIO –
EKONOMIKE MIDIS QENDRËS DHE PERIFERISË NË BASHKINË
TIRANË**

***TWO ALBANIAS IN ONE CITY: SOCIO – ECONOMIC INEQUALITIES
BETWEEN THE CENTER AND THE PERIPHERY IN THE
MUNICIPALITY OF TIRANA***

PhD. Cand. ORNELA HASRAMA

Universiteti i Tiranës

ornela.hasrama@unitir.edu.al

Dr. EDLIRA ÇARO (KOLA)

Universiteti i Tiranës

edlira.kola@unitir.edu.al

Prof. Dr. SOKOL AXHEMI

Universiteti i Tiranës

sokol.axhemi@unitir.edu.al

Prof. as. Dr. SONILA SINJARI (XHAFI)

Universiteti i Tiranës

sonila.xhafa@unitir.edu.al

FISNIK MULGECI

Universiteti i Tiranës

fisnik_mulgeci.fhfstudent@unitir.edu.al

BRUNILDA SHIRA

Universiteti i Tiranës

brunilda_shira.fhfstudent@unitir.edu.al

Abstract

Economic and social inequalities represent one of the most prominent challenges across various geographical spaces, not only for territories striving to achieve sustained positive development, but also for those already integrated within developed countries. These socio – economic imbalances manifest in multiple forms, including the unequal distribution of income, disparities in employment opportunities, limited access to education and healthcare services,

varying quality of life, and uneven standards of public infrastructure, among others. In the context of cities undergoing rapid urbanization, as is the case with Tirana, these inequalities become further exacerbated, raising critical issues for discussion such as social justice and the equitable functioning of territorial spaces. This paper aims to analyze and compare the socio – economic imbalances that exist between urban areas, commonly referred to as the “center,” and rural areas, regarded as the “periphery,” within the Municipality of Tirana.

Based on fieldwork, the study explores how urban development dynamics have given rise to two distinct realities within the same city, an urban Tirana, integrated into international networks, and a rural periphery, often excluded from the benefits of territorial development within the municipality. Through this research, the reciprocal interaction between the center and the periphery is brought to light, where the periphery supplies the center with human, agricultural, and territorial resources, while remaining marginalized in both decision – making processes and the distribution of development benefits. This imbalanced relationship generates a center – periphery system that calls for rethinking within the framework of sustainable development policies and territorial cohesion. Consequently, territorial planning is identified as an essential instrument for promoting more equitable and inclusive territorial development, one that addresses not only infrastructural needs but also the social and economic demands of the local population. In this context, the study contributes to the broader discourse on sustainable urban development and the challenges of territorial cohesion within the Albanian context.

Keywords: *unbalanced development, spatial exclusion, urban – rural interaction, socio – economic inequality, spatial justice*

Hyrje

Koncepti ndaj qendrës dhe periferisë është trajtuar në këndvështrime të ndryshme nga autorë të cilët janë shprehur shpeshherë edhe me qëndrime të kundërta nga njëri – tjetri. “Qendra” dhe “periferia” janë terma të rëndësishëm, të cilët kanë iniciuar teorinë e varësisë dhe të dominancës gjatë viteve 1960 dhe 1970, kjo për të shpjeguar progresin ose regresin në zhvillimin e një territori të caktuar. Modeli qendër – periferi është i dobishëm jo vetëm në nivel global, por edhe në një këndvështrim lokal, veçanërisht për të kuptuar ndërvlerësinë midis zonës urbane dhe zonës rurale¹. Në nivel global, qendra përfaqëson vendet ekonomikisht të zhvilluara dhe të industrializuara, të cilat dominojnë tregtinë ndërkombëtare, financat dhe inovacionin e teknologjinë, ndërsa periferia kompozohet nga vende më pak të zhvilluara, të cilat i eksportojnë burimet e tyre natyrore dhe ofrojnë fuqi punëtore për vendet e zhvilluara.

Në nivel lokal, kjo marrëdhënie midis qendrës dhe periferisë, krijon modele të ndërvlerësisë ku zonat rurale varen nga tregjet, shërbimet dhe politikat urbane. Megjithatë, domethënia e qendrës dhe periferisë duhet të kuptohen si përshtatëse dhe jo si gjykime për të vlerësuar një vend². Autori *Petr Kyloušek* (2024) e konsideron qendrën si një territor i cili e udhëheq periferinë, që ka një vazhdimësi, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, vetëzhvillim, origjinalitet, si dhe e orientuar drejt prodhimit. Ndërkohë, periferinë autori e konsideron si një territor i cili nuk ka një vazhdimësi, është i paqëndrueshëm ekonomikisht, imiton politikat e qendrës, apo që nuk ka qasje ndaj prodhimit por ndaj pranimit.

“Qendra” dhe “periferia” mund të përcaktohen në një hapësirë simbolike, ose duke përdorur terminologjinë e *Pierre Bourdieu*, në një hapësirë sociale, ku marrëdhëniet pushtetore dhe burimet kulturore, ekonomike apo simbolike luajnë një rol vendimtar në formësimin e këtyre nocioneve³. *Stein Rokkan*, një studiues klasik në këtë fushë, i njohur për shumë artikuj teorikë mbi ndarjet qendër – periferi të perceptuara në terma të dimensioneve politike dhe kulturore, ku qendrën e shpreh si zona e dominimit politik e cila përdor mekanizmat e shtetit për të nënshtruar gjithë territoret pranë vetes. Në studimet e tij, Rokkan thekson gjithashtu dimensionin kulturor të rëndësishëm të tensioneve midis qendrës dhe

¹Batur. S, *Center and Periphery*, Encyclopedia of Critical Psychology, Springer, New York, 2014, https://doi.org/10.1007/978-1-4614-5583-7_37

² Kyloušek. P, *What is the center and what is the periphery?*, *Centers and Peripheries in Romance Language Literatures in the Americas and Africa*, Studies in Comparative Literature, Vol. 105, 2024, pg. 17 – 42, ISBN: 9789004691131, https://doi.org/10.1163/9789004691131_003

³ Bourdieu P., Wacquant L.J.D., *Zaproszenie do socjologii refleksyjnej*, Warszawa: Oficyna Naukowa, 2001

periferisë⁴. Ndërkohë, në aspektin gjeografik, modeli qendër – periferi ka gjetur aplikim në kontekste të larmishme, si në ndikimet e distancës midis zhvillimit të qendrës dhe periferisë, ashtu edhe në integrimin e periferisë në drejtim të qendrës, apo analizave të shpërndarjes së aktiviteteve ekonomike, sociale dhe politike në hapësirë. Padyshim që me zhvillimet e reja territoriale evidentohet fakti se nuk ka një kategorizim të ngurtë të zonës urbane me atë rurale, por ekzistojnë edhe zona të ndërmjetme të cilat gëzojnë tipare mikse duke gërshetuar veçoritë e zonave rurale me ato urbane. Në këtë mënyrë, një gjeograf ka hapësira të mjaftueshme për të trajtuar modelin qendër – periferi në kontekste të ndryshme. Megjithatë, modeli qendër – periferi ka një qasje pluridisiplinare dhe shumëfaqëshe ku fushat lidhen bashkë me njëra – tjetrën kur analizojmë dinamikat komplekse të modelit, p.sh një qasje pluridisiplinare është përdorur për të trajtuar probleme që lidhen me zhvillimin ose marginalizimin. Kombinimi i disiplinave të ndryshme rreth këtij modeli (sociologji, ekonomi, gjeografi) na ndihmon të ekzaminojmë një analizë më të kompletuar.

Tiparet e modelit qendër – periferi shfaqen edhe në territorin e bashkisë Tiranë. Aktualiteti evidenton mënyrën se si dinamika të ndryshme zhvillimi kanë ndikuar në krijimin e dy realiteteve kontrastuese brenda të njëjtit qytet, një Tiranë urbane, e lidhur ngushtë me rrjete ekonomike dhe sociale ndërkombëtare, dhe zona periferike, të cilat shpeshherë nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë nga zhvillimet territoriale. “Qendra” e Tiranës përfiton nga investime intensive, cilësi më e lartë e shërbimeve dhe akses i përmirësuar në burime, ndërsa zonat “periferike” përballen me mungesë të infrastrukturës bazë, mosaksesim i shërbimeve, apo edhe me nivel më të ulët arsimit si rezultat i kushteve sociale dhe ekonomike të familjeve. Në përgjithësi, zonat me profil rural të bashkisë Tiranë, të konsideruara si territore “periferike”, kanë potenciale për zhvillim të ekonomisë së gjelbër dhe të qëndrueshme, por përballen ende me mungesë infrastrukture, kufizim në shërbime publike dhe vëmendje të zbehur institucionale. Nga ana tjetër, zonat urbane shprehin disa karakteristika të ndryshme nga zonat rurale, si territore të ndikuara nga zhvillimi informal, mungesa e planifikimit të qëndrueshëm dhe presionit urban, mungesa e hapësirave publike funksionale, shërbimeve të plota arsimore dhe shëndetësore, si dhe mundësitë e ulta të punësimit. Të dyja kahet, ndonëse me karakteristika të ndryshme, identifikojnë dimensionet e pabarazisë territoriale në Tiranë. Tiparet e zonave urbane dhe rurale theksojnë nevojën për një qasje më të balancuar dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave publike, ku investimet dhe zhvillimi të orientohen drejt barazisë territoriale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së popullsisë lokale.

⁴ Lipset S.M., Rokkan S., *Cleavage structures, party systems, and voter alignments: an introduction*, Party Systems and Voter Alignments, New York, 1967

Rishikim literature

Pabarazitë sociale dhe ekonomike janë trajtesa të cilat nuk kanë vlerë vetëm në aspektin statistikor, për të identifikuar apo renditur vendet e ndryshme të botës sipas zhvillimit të tyre ekonomik, por është përtej kësaj. Pabarazitë sociale dhe ekonomike prekin individin, grupe të ndryshme sociale, shoqërinë e një vendi. Pabarazitë sociale dhe ekonomike i referohen shpërpjesëtimeve në shpërndarjen e burimeve, mundësive, si dhe mirëqënies së një shoqërie. Kjo manifestohet në forma të ndryshme, si në aspektin e të ardhurave, mirëqënien shëndetësore, aksesin në arsim, apo edhe dimensione të tjera jetësore. Koncepti i pabarazisë territoriale, i trajtuar gjerësisht nga teoricienë si *David Harvey* dhe *Henri Lefebvre*, fokusohet në mënyrën se si hapësira urbane prodhohet dhe riprodhohet në mënyrë që përforcon pabarazitë shoqërore dhe ekonomike. Lefebvre (1973) argumenton se hapësira nuk është thjesht një sfond pasiv, por produkt i marrëdhënieve shoqërore, ku fuqitë ekonomike dhe politike ndikojnë në mënyrën si organizohet dhe qeveriset qyteti⁵. Harvey (1973) nga ana tjetër, thekson rëndësinë e së drejtës për qytetin, si një kërkesë për drejtësi sociale dhe barazi në shpërndarjen e burimeve urbane dhe aksesit në shërbime⁶. Autorë të ndryshëm shqyrtojnë, matin, vlerësojnë dhe analizojnë indikatorë të larmishëm për të evidentuar pabarazitë socio – ekonomike. Sipas autorëve *Akram* dhe *Pervaiz* (2024), janë disa indekse që shërbejnë si masa shumëdimensionale të pabarazisë. Secila prej këtyre masave pasqyron shkallën e pabarazisë së mundësive në një dimension të caktuar të jetës njerëzore, që lidhet me sferat sociale, gjinore, gjeografike, socio – ekonomike dhe politike⁷. Ndërkohë, për autorët *Marrero* dhe *Rodríguez* (2012), janë disa faktorë që ndikojnë dhe duhen marrë në konsideratë në pabarazitë socio – ekonomike, të cilat jo domosdoshmërisht përzgjidhen nga individ. Në përgjithësi, faktorët që lidhen me racën, etninë, kategorinë sociale, gjininë, vendin e lindjes, si dhe arsimin, përdoren si një grup rrethanash që janë jashtë kontrollit të individit⁸. Nga ana tjetër, *Ferreira et al.*, cilëson se cilëson se, për të vlerësuar pabarazinë e mundësive midis individëve në vende të ndryshme,

⁵ Lefebvre. H, *The production of space*, Blackwell Publishing. pg. 68 (Original work published 1974), [1991](https://iberian-connections.yale.edu/wp-content/uploads/2020/04/The-production-of-space-by-Henri-Lefebvre-translated-by-Donald-Nicholson-Smith.pdf)

<https://iberian-connections.yale.edu/wp-content/uploads/2020/04/The-production-of-space-by-Henri-Lefebvre-translated-by-Donald-Nicholson-Smith.pdf>

⁶ Harvey. D, *Social Justice and the City*. University of Georgia Press, pg. 96, 1973 <https://erikafontanez.com/wp-content/uploads/2017/09/david-harvey-social-justice-and-the-city.pdf>

⁷ Akram. S, Pervaiz. Z, *Estimation of inequality of opportunities across countries: a multidimensional approach*, Studies in Economics and Econometrics, 48(1), 18–41, 2024

⁸ Marrero. GA, Rodríguez. JG, *Inequality of opportunity in Europe*, Income Wealth 58(4), 597–621, 2012, <https://doi.org/10.1111/j.1475-4991.2012.00496.x>

disa studime kanë marrë në konsideratë rrethana në nivel makro, si tensionet etnike dhe fetare, kapitalin njerëzor, nepotizmin, përfitimin përmes “lidhjeve” dhe nivelin e zhvillimit ekonomik në shoqëri⁹. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se përzgjedhja e faktorëve ndryshon nga një studim në tjetrin, në varësi të natyrës dhe kontekstit të studimit, si dhe të disponueshmërisë së të dhënave¹⁰. Për autorët *Tóth et al.*, pabarazitë janë thellësisht të rrënjësura në histori, që nga qasja e pabarabartë ndaj arsimit apo teknologjisë deri te shërbimet publike që përbëjnë mekanizma vetëforcues përmes të cilëve pabarazia ekonomike përshkallëzohet nga një brez në tjetrin¹¹. Për të shmangur këto pabarazi, veçanërisht në zonat rurale, sugjerohet të merren disa masa. Autorët *Mao et al.*, konstatojnë se rritja e aktiviteteve të sipërmarrjes sociale korrelohet me një ulje të pabarazisë ekonomike. Për më tepër, ata sugjerojnë se sipërmarrja sociale ndikon në reduktimin e pabarazisë ekonomike duke përshpejtuar procesin e urbanizimit të popullsisë, duke nxitur punësimin jashtë sektorit bujqësor dhe duke rritur të ardhurat në zonat rurale¹². Këto pabarazi, jo qëllimisht, sjellin edhe problematika të cilat lidhen me mjedisin, duke prekur në këtë mënyrë trekëndëshin e komponentëve të zhvillimit të qëndrueshëm. Pabarazia sociale dhe ekonomike në vende apo rajone të ndryshme mund të përbëjë një pengesë të rëndësishme për zbatimin e një politike mjedisore efektive. Në përgjithësi, njerëzit që janë në kushte të pafavorizuara ekonomike janë shpesh më të prekshmit nga pasojat negative të degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike. Ata gjithashtu mund të mos kenë fuqinë politike dhe burimet e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre përmes politikave përkatëse. Për shembull, komunitetet me të ardhura të ulëta preken në mënyrë disproporcionale nga ndotja dhe rreziqet mjedisore, si vendgrumbullimet e mbetjeve toksike dhe ndotja e ajrit nga fabrikat¹³. Në këtë

⁹ Ferreira. FH, Lakner. C, Lugo. MA, Özler. B, *Inequality of opportunity and economic growth: how much can cross-country regressions really tell us?* *Incom Wealth* 64(4), 800–827, 2018

¹⁰ Akram. S, Pervaiz. Z, *Multidimensional inequality, social cohesion, and economic growth*, *J. Soc. Econ. Dev*, 2025, <https://doi.org/10.1007/s40847-025-00436-x>

¹¹ Tóth. G, Wachs. J, et al., *Inequality is rising where social network segregation interacts with urban topology*, *Nature Communications*, 2019, <https://doi.org/10.1038/s41467-021-21465-0>, https://www.researchgate.net/publication/336059312_Inequality_is_rising_where_social_network_segregation_interacts_with_urban_topology

¹² Mao. D, Chen. J, Hu. S, *Urban-rural economic inequality: is social entrepreneurship the solution?*, *China Agricultural Economic Review*, 2025, <https://doi.org/10.1108/CAER-12-2023-0371>

¹³ Naydenov. K, *Social and economic inequality as a brake on effective environmental policy*, *Economics of Sustainability and Environmental Policies*, Vol. 24, 2025, DOI: [10.5593/sgem2024v4.2/s20.57g](https://doi.org/10.5593/sgem2024v4.2/s20.57g)

mënyrë, evidentojmë faktin se pabarazitë sociale dhe ekonomike nuk çenojnë vetëm individin apo një kategori të caktuar shoqërore, përkundrazi, ndikimi i këtyre pabarazive ka një rreze mjaft të gjerë.

Në kontekstin e rastit studimor të bashkisë Tiranë vihet re se ky territor ka zhvillim social dhe ekonomik të diversifikuar. Zhvillimi urban në qytetet në tranzicion, si Tirana, karakterizohet shpesh nga një rritje e pabalancuar dhe dinamika të theksuara të përqendrimit të burimeve në zonat qendrore, që krijojnë kontraste të forta me periferitë urbane. Ky fenomen evidenton një problematikë thelbësore të zhvillimit territorial, të njohur në literaturën akademike si pabarazia territoriale, e cila përfshin ndarjen e pabarabartë të mundësive ekonomike, aksesit në shërbime dhe cilësisë së jetës midis pjesëve të ndryshme të qytetit¹⁴. Përveç aspekteve materiale dhe infrastrukture, pabarazia territoriale pasqyron edhe thellësisht pabarazitë sociale dhe kulturore që ndikojnë në mënyrën se si popullsia lokale jeton dhe zhvillohet në hapësirë. Në kontekstin shqiptar, dhe veçanërisht në Tiranë, kjo ndarje mes qendrës dhe periferisë merr formë të ndryshme, ku zhvillimi urban ka ndjekur një rrugë jo të balancuar dhe shpesh të paqëndrueshme¹⁵. Në literaturën shkencore, qendra urbane trajtohet si hapësira ku përqëndrohen investimet kryesore infrastrukture, aktivitetet ekonomike dhe institucionet publike, duke përfutur në mënyrë disproporcionale nga politikat zhvillimore dhe resurset ekonomike¹⁶. Përkundrazi, periferitë shpesh karakterizohen nga një shkallë më e ulët e zhvillimit, mungesa e shërbimeve bazë, si arsimi, shëndetësia, transporti publik, si dhe nga një mungesë e mundësive ekonomike që çon në marginalizim social dhe ekonomik¹⁷. Këto ndryshime territoriale ndikojnë në pabarazi të thella në cilësinë e jetës, duke e bërë pabarazinë territoriale një sfidë kryesore për planifikimin urban dhe politikat sociale në qytetet në zhvillim, si në rastin e Tiranës.

¹⁴ Harvey. D, *Social justice and the city*, University of Georgia Press, 1973, <https://www.encyclopedia.com/social-sciences/applied-and-social-sciences-magazines/harvey-david>

¹⁵ Marku. B, *Urban development challenges in transition: The case of Tirana*. European Journal of Geography, 6(2), 45-58, 2015, https://www.researchgate.net/publication/339553192_TIRANA_the_Challenge_of_Urban_Development

¹⁶ Fainstein. S, *The just city*, Cornell University Press, pg. 57, 2010, https://books.google.al/books?vid=ISBN9780801462184&printsec=index&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false

¹⁷ Marcuse. P, *From Critical Urban Theory to the Right to the City*, City 13 (2–3), 185–97, 2009, <https://doi.org/10.1080/13604810902982177>

Metodologjia

Studimi bazohet tërësisht në metodën e punës në terren, kryer nëpërmjet pyetësorit të kompozuar me pyetje të mbyllura dhe të hapura, duke u gjykuar si instrumenti më i përshtatshëm, për realizimin e punimit, si rezultat i natyrës sasiore dhe cilësore të informacionit që nevojitej për të grumbulluar nga terreni. Përzgjedhja e të anketuarve u bazua në një kampionim të rastësishëm, ku i vetmi tregues i përcaktuar ishte një ndarje e mirëfilltë midis identifikimit të të anketuarve që banojnë në zonë urbane dhe të anketuarve që banojnë në zonë rurale. Nga ana tjetër, janë siguruar edhe intervista me aktorë lokalë të zonave të përzgjedhura me qëllimin për të identifikuar vizionin dhe qasjen që ka ky target grup për të zbutur pabarazitë hapësinore midis qendrës dhe periferisë. Njësitë Administrative të përzgjedhura ishin dy rurale (Zall – Herr, Dajt) dhe dy urbane (Nj. A. nr 5, Nj. A. nr 11) të bashkisë Tiranë. Anketimet u kryen përgjatë muajit maj, të vitit 2025, me një numër të anketuarish prej 172 në total, ku 86 anketime i përkasin popullsisë banuese në zonë urbane dhe 86 anketime të popullsisë banuese në zonë rurale, si një mostër e konsiderueshme për të kuptuar realitetin dhe trendet lidhur me tematikën e trajtuar. Kohëzgjatja e pyetësorit ishte rreth 10 minuta, realizuar pjesërisht online (Google Form) dhe pjesërisht ballë për ballë. Pyetësi u kompozua me 14 pyetje, ku 9 prej tyre ishin të mbyllura (nga të cilat 2 pyetje ishin të kategorizuara sipas shkallës Likert dhe 7 pyetje me alternativa të shumëfishta), si dhe 5 pyetje të hapura ku të anketuarit duhet të shprehnin mendimin e tyre lidhur me çështjen. Pyetësi ishte një kombinim për grumbullimin e të dhënave cilësore dhe sasiore, me qëllimin për të mbledhur, analizuar, përpunuar dhe krahasuar të dhënat e siguruar, duke u fokusuar në perceptimet e të anketuarve, banorë në zonat rurale dhe urbane të bashkisë Tiranë, lidhur mundësitë ekonomike, qasjen ndaj shërbimeve, si dhe sfidat që karakterizojnë jetesën në zona urbane dhe rurale brenda Bashkisë Tiranë.

Rezultate dhe diskutime

Cili është profili social i popullsisë së anketuar?

Popullsia e anketuar, kampionimi i studimit, ka një larmishmëri të evidentueshme në kontekstin e të dhënave të përgjithshme që ata përfaqësojnë, të siguruar nga puna në terren. Pyetësi i realizuar në katër njësitë administrative ka patur një përqindje pothuajse të ekuilibruar për sa i përket numrit të individëve të përfshirë në pyetësor, mesatarisht 25% për çdo njësi të përfshirë. Kjo shpërndarje gjeografike ka ndihmuar për të ndërtuar një balancë të ekuilibruar të numrit të popullsisë së përfshirë në pyetësor, me qëllim ndërtimin e një raporti të drejtë midis analizave dhe krahasimeve të të anketuarve që banojnë në zonat

urbane dhe të anketuarve banues në zonat rurale. Profili demografik i popullsisë së anketuar ka disa karakteristika. Në kontekstin e përkatësisë gjinore, për zonat urbane dhe rurale, ka një pjesëmarrje prej 58% të gjinisë femërore dhe 42% të meshkujve. Grupmosha e të anketuarve kompozohet në gjashtë kategori dhe përbërja e tyre paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Grupmosha e popullsisë së anketuar (në %)

Grupmosha (në vjeç)	nën 18	18 – 30	31 – 40	41 - 50	51 - 65	mbi 65
<i>Në përqindje (%)</i>	8	35	19	15.5	13	9.5

Burimi: Të dhëna bazuar në rezultatet e pyetësorit

Në këtë përbërje të grupmoshave dominon popullsia 18 – 30 vjeç dhe 31 – 40 vjeç, të cilat kanë përqindjet më të larta si dy grupmosha të anketuara më shpesh. Megjithatë, popullsia e anketuar është e larmishme dhe ka një kompozim divers në kontekstin e grupmoshave. Nga ana tjetër, vihet re një diferencim në nivelin e ndjekjes së arsimit të popullsisë, edhe pse dominuese në pjesëmarrjen në anketim është popullsia në moshë të re, konstatohet se në zonat rurale dominon përqindja e popullsisë me arsim të mesëm, ndërsa në zonat urbane dominon popullsia me arsim universitar.

Tabela 2. Niveli arsimor i popullsisë së anketuar

Niveli arsimor	Arsim bazë	Arsim i mesëm	Arsim universitar	Arsim pasuniversitar
<i>Zonat urbane (në)</i>	16,7	30	51.7	1.6
<i>Zonat rurale (në %)</i>	28	46	26	-

Burimi: Të dhëna bazuar në rezultatet e pyetësorit

Këto tregues mbeten mjaft të rëndësishëm në kontekstin e studimit të pabarazive socio – ekonomike për arsye sepse janë të lidhura ngushtë me mundësitë e punësimit dhe tregun e punës, mënyrën e jetesës apo edhe tregues të tjerë të cilët janë të lidhura me mirëqënien e popullsisë.

Të ardhurat dhe punësimi: midis “qendrës” dhe “periferisë”

Zonat “qendër” dhe “periferi” ndryshojnë nga njëra – tjetra në bazë të treguesve ekonomikë. Këto dallime dhe ndarje funksionale midis zonave nënvizojnë nevojën për politika të diferencuara zhvillimi dhe punësimi që marrin në konsideratë specifikat socio – ekonomike të secilit territor. Për të bërë dallimin midis territoreve të marra në studim, më poshtë paraqitet tabela nr. 3, mbi treguesit ekonomikë të popullsisë së anketuar.

Tabela 3. Tregues ekonomikë të popullsisë së anketuar

Fushat	Detajet	Zall – Herr	Dajt	Mes. në Zonat Rurale	Nj. A. nr. 5	Nj. A. nr. 11	Mes. në Zonat Urbane
Statusi i punësimit	<i>Të punësuar</i>	60.98	43.7	52.34	46.7	40	43.35
	<i>Të vetëpunësuar</i>	14.63	16.4	15.51	8.3	31.1	19.7
	<i>Të papunë</i>	24.39	40	32.19	45	28.9	36.95
Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë	<i>Sektori i parë i ekonomisë</i>	20	14	17	15	3	9
	<i>Sektori i dytë i ekonomisë</i>	35	30	32.5	25	20	22.5
	<i>Sektori i tretë i ekonomisë</i>	44	38	41	50	70	60
	<i>Tjetër</i>	1	18	9.5	10	7	8.5
Të ardhurat mujore familjare	<i>Deri në 300 euro</i>	7	6	6.5	3	6.8	4.9
	<i>Deri në 600 euro</i>	30	30	30	43.7	31.8	37.75
	<i>Deri në 900 euro</i>	32	34	33	35	34.1	34.55
	<i>Deri në 1200 euro</i>	25	23	24	11.7	20	15.85
	<i>Mbi 1200 euro</i>	6	7	6.5	6.7	7.3	7

Burimi: Të dhëna bazuar në rezultatet e pyetësorit

Sipas të dhënave të grumbulluara, në krahasimin midis zonave urbane dhe zonave rurale paraqitet një shkallë më e lartë punësimi i drejtpërdrejtë. Mesatarisht, 52.34% e të anketuarve në zonat rurale janë të punësuar, përkundrejt 43.35% në zonat urbane. Ky fakt identifikon një përfshirje më të gjerë të popullsisë rurale në aktivitetet ekonomike, kjo si rezultat i angazhimit të popullsisë në sektorin bujqësor, në “pronën” e tyre.

Nga ana tjetër, vetëpunësimi është më i përhapur në zonat urbane (19.7%) se sa në zonat rurale (15.51%), e cila mund të shpjegohet me natyrën më fleksibël të tregut të punës në qytet dhe me mundësinë për të zhvilluar aktivitete private apo të vogla biznesi, megjithatë në këtë tregues mund të ketë hapësira për interpretim për shkak se disa prej popullsisë së anketuar e percepton angazhimin në bujqësi si vetëpunësim dhe disa të tjerë, si rezultat i prodhimtarisë së ulët të produkteve bujqësore, e konsideron si angazhim për vetëkonsum. Ndërsa papunësia mbetet problem më i madh në zonat urbane, me një përqindje mesatare prej 36.95%, krahasuar me 32.19% në zonat rurale, duke identifikuar një konkurrencë më të lartë për vende pune apo mungesë përputhshmërie midis kërkesës dhe ofertës në tregun urban. Struktura e punësimit sipas sektorëve tregon qartë ndarjen midis zonave rurale dhe atyre urbane. Në zonat rurale, dominon sektori i parë i ekonomisë (bujqësia, pylltaria etj.) me një përqindje mesatare prej 17%, ndërsa në zonat urbane ky sektor përfaqëson vetëm 9% të punësimit. Kjo është në përputhje me orientimin e zonave rurale drejt ekonomive me bazë burimet natyrore. Edhe sektori i dytë, që përfshin industrinë dhe ndërtimin, është më i përhapur në zonat rurale (32.5%) krahasuar me urbanet (22.5%), çfarë dëshmon për një potencial prodhues më të zhvilluar në zonat përreth qytetit. Ndërsa, sektori i tretë i ekonomisë, shërbimet, është shumë më dominant në zonat urbane, me 60.8% të të punësuarve, përkundrejt 41% në zonat rurale. Kjo pasqyron tiparin klasik të qyteteve si qendra shërbimesh, administrate dhe tregtie. Kategoria “tjetër” mbetet relativisht e ulët në të dyja zonat, megjithëse pak më e lartë në ato rurale, me 1.6% diferencë. Me kategorinë “tjetër” i është referuar sektorit të katërt të ekonomisë (aktiviteteve që lidhen me njohurinë, informacionin, teknologjinë dhe kërkimin shkencor) apo edhe punëve sezonale. Të dhënat e të ardhurave familjare dëshmojnë për një shpërndarje të ndryshme midis zonave rurale dhe urbane. Në zonat urbane, përqindja më e madhe e familjeve (37.75%) deklarojnë të ardhura mujore deri në 600 euro, ndërsa në zonat rurale kjo përqindje është 30%. Nga ana tjetër, përqindja më e lartë në zonat rurale e familjeve me të ardhura mesatare në intervalin 900-1200 euro (24%) krahasuar me ato urbane (15.85%) mund të shpjegohet me ndikimin e kombinimit të burimeve të të ardhurave (bujqësi, shërbime dhe remitanca). Përqindjet e familjeve me të ardhura shumë të ulëta (deri në 300 euro) dhe shumë të larta (mbi 1200 euro) janë të ngjashme në të dyja zonat, rreth 6 – 7%, çfarë dëshmon për një nivel të përgjithshëm relativisht të kufizuar të mirëqenies ekonomike në të dyja kontekstet territoriale. Në lidhje

me përbërjen e familjeve, të dhënat dëshmojnë se zonat rurale kanë një prirje më të lartë drejt strukturave familjare të mëdha. Nga të dhënat e terrenit rezultojnë se numri dominues i anëtarëve të familjes është midis 4 – 6 anëtarë, me mbi 35%, madje 7.32% e të anketuarve pohojnë se familjet e tyre përbëhen nga më shumë se 6 persona. Kjo strukturë përkon me modelet tradicionale të bashkëjetesës ndër breza, tipike për zonat rurale dhe periferike. Ndërsa zonat urbane rezultojnë të kenë përqindje më të lartë të familjeve midis 4 – 6 anëtarë, me 28.9%, por familjet më të mëdha, me më shumë se 6 anëtarë, janë më të pakta, me vetëm 4% . Këto të dhëna dëshmojnë për krijimin e strukturave familjare drejt modelit të familjes bërthamë, ku bashkëjetesa ndër breza është më e rrallë, për shkak të kostove më të larta të jetesës, hapësirës më të kufizuar, dhe ndryshimeve në stilin e jetës. Edhe në aspektin e vendbanimeve, p.sh në zonat urbane, vetëm 43.3% e popullsisë së anketuar janë pronarë të shtëpisë, ndërsa 20% jetojnë në banesa të trashëguara dhe 18.3% me qira, duke reflektuar pasiguri strehimi për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Ndërkohë, në aspektin e shpenzimeve mujore, 66.7% e të anketuarve shpenzojnë më së shumti për ushqim, duke lënë shumë pak hapësirë për shpenzime të tjera si arsim (10%) apo investime (7%), gjë që tregon se një pjesë e madhe e familjeve gjenden në kufijtë e minimumit jetik.

Qasja në shërbime: A gjenden disbalanca?

Zhvillimet sociale janë ndër elementët më të identifikueshëm në këndvështrimin e pabarazive midis territoreve të ndryshme. Në kuadër të këtij studimi, për katër zonat e kampionimit, janë evidentuar tregues krahaskimorë si edukimi dhe shkollat, shërbimi shëndetësor, si dhe transporti publik. Të dhënat dhe puna në terren evidentojnë ndryshime të evidentueshme përmes mënyrës se si është e shpërndarë gjeografikisht cilësia e arsimit në zona të ndryshme. Në zonat urbane shkollat janë më pranë zonave të banuara, kanë staf më të kualifikuar, laboratore dhe ambiente të mirëmbajtura. Gjithashtu, vihet re një numër më i lartë i institucioneve private, mundësitë për kurse shtesë, aktivitete më të diversifikuara jashtëshkollore, si dhe infrastrukturë digjitale më të shpeshtë dhe funksionale. Ndërkohë, në zonat rurale shkollat janë më në distancë, me mungesë stafi pedagogjik të kualifikuar, si dhe në disa raste infrastruktura shkollore është e amortizuar, pa ambiente sportive, pa laboratorë funksionalë apo pajisje didaktike moderne. Këto mungesa sjellin përjashtim të nxënësve të zonave rurale nga arsimi cilësor, elementë që me kalimin e kohës këto disbalanca nuk janë më vetëm arsimore, por shndërrohen në kufizime konkrete për punësim, integrim shoqëror dhe zhvillim të qëndrueshëm social.

Në këndvështrimin e shërbimeve shëndetësore evidentohet se në zonat “qendër” gjenden qendra shëndetësore funksionale, me akses të shpejtë në spitale rajonale dhe private, si dhe me staf të specializuar në fusha të ndryshme

mjekësore. Ndërsa në zonat rurale shërbimet janë të përqëndruara në një ose dy qendra shëndetësore, të cilat shpesh ndeshin mungesë të stafit të përhershëm mjekësor, sidomos specialistëve, dhe janë të pajisura vetëm me elementët bazikë për diagnostikim dhe trajtim të sëmundjeve të ndryshme. Mungesa e ambulancave, distanca nga spitalet kryesore dhe infrastruktura e dobët e vendos popullsinë në presion të vazhdueshëm mbi pabarazitë sociale midis territoreve, ku shpeshherë shumë banorë detyrohen të udhëtojnë drejt zonave urbane të Tiranës për shërbime bazë ose të specializuara mjekësore.

Situata identifikohet me të njëjtat ngjyime edhe në aspektin e transportit publik. Në zonat urbane transporti publik është më prezent, i shpeshtë dhe i mirëintegruar me rrjetin urban të Tiranës, duke mundësuar lëvizje të shpejtë për punë, arsimim dhe shërbime. Prania e disa linjave urbane dhe afërsia me unazën e qytetit i lejon banorët të kenë zgjedhje dhe fleksibilitet në udhëtim, duke reduktuar kohën e lëvizjes nga një vend në tjetrin. Ndërsa në zonat rurale transporti publik është i rrallë, shpesh jo i përhershëm dhe me itinerare të kufizuara. Automjetet janë më të pakta në numër, oraret janë të paqëndruara në orare të caktuara dhe mungon lidhja direkte me qendrat kryesore të qytetit. Për shumë banorë, veçanërisht të rinjtë që ndjekin arsimin në qytet, apo të punësuarit që udhëtojnë çdo ditë, kjo situatë përbën një pengesë të vazhdueshme. Izolimi i transportit përkthehet në izolim social dhe ekonomik, dhe kufizon mundësinë për integrim aktiv në jetën shoqërore.

Perceptim dhe realitet: Çfarë mendojnë banorët?

Puna në terren dëshmon një panoramë komplekse, ku bashkëjeton ndjesia pozitive për natyrën dhe përkatësinë, me pakënaqësi të theksuara për aksesin në shërbime bazë dhe mungesën e zhvillimit të territorit. Nga njëra anë, shumë prej banorëve shprehin vlerësim për mjedisin natyror dhe qetësinë që ofron periferia, por nga ana tjetër, janë të pakënaqur me mungesën e shërbimeve cilësore bazë dhe me ndjenjën e përjashtimit nga zhvillimi që po ndodh në zona të caktuara të Tiranës. Një pjesë e mirë e banorëve deklarojnë se janë të lidhur me zonën për arsye familjare, kulturore apo tradicionale. Familjet që kanë jetuar ndër breza në të njëjtin vendbanim, veçanërisht në zonat rurale, shfaqin lidhje më të forta emocionale me territorin. Prania e tokës së trashëguar, ndjenja e përkatësisë, stili i jetesës, si dhe kostot më të ulëta të jetesës përmenden si arsye pse vazhdojnë të jetojnë në këto zona. Kur të anketuarit u pyeten për mundësitë që zona rurale u ka ofruar përgjigjet ishin jo shumë pozitive. Banorët theksojnë mungesën mundësive për të rinjtë, vështirësitë për të gjetur punë brenda njësisë, si dhe mungesën e aktiviteteve kulturore apo sociale. Për shumë të rinj, zonat rurale shihen si hapësira të mbyllura, që ofrojnë pak mundësi zhvillimi personal dhe profesional. Sipas intervistave dhe pyetësorëve të kryer, të rinjtë shfaqin pakënaqësi më të

lartë, pasi e vlerësojnë pabarazinë më të lartë në zonat rurale. Ata identifikojnë më shumë vështirësi për të ndjekur shkollat e mesme apo universitetet në qytet për shkak të infrastrukturës fizike dhe transportit, dhe ndihen të përjashtuar nga aktivitetet sociale e kulturore që ndodhin në qendër.

Në aspektin e shërbimeve publike, të anketuarit perceptojnë se në zonat rurale ka prani të shërbimeve minimale dhe të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e popullsisë lokale. Një pjesë e të anketuarve shprehen se ata i kanë ndarë shqetësimet e tyre me institucionet përkatëse, por nuk kanë marrë përgjigje konkrete. Ata shprehen se zhvillimi në zonë ndodh ngadalë dhe shpesh pa u konsultuar me komunitetin, ndërsa prioritetet vendosen pa marrë parasysh nevojat reale të përditshme të banorëve.

***Politikat që duhet të ndërmerren për të zogëluar ndarjen qendër – periferi.
A mund të flasim për një Tiranë të qëndrueshme?***

Nëse duhet të sjellim rezultate pozitive në zonat urbane dhe rurale, në kontekstin e zhvillimeve socio – ekonomike, duhet punuar me politikat e duhura për të zbehur ndarjen qendër – periferi. Në njësitë urbane dëshmohet se herëpashere ka projekte infrastrukturore, si ndërtimi i shkollave, kopshteve dhe rikonstruksioni i rrugëve, të cilat përfaqësojnë një përpjekje për të zbutur pabarazitë hapësinore midis qendrës dhe periferisë. Megjithatë, mungesa e çerdheve, këndeve të lojërave dhe qendrave sociale evidenton se politikat urbanistike janë ende të pjesshme dhe jo të integruara. Kjo krijon një ndarje të qartë midis cilësisë së shërbimeve publike në qendër dhe periferi, fakte të dëshmuara edhe nga aktorë të vendimmarjes në zonat përkatëse mbi politikat urbanistike dhe impaktin e tyre në pabarazitë apo përjashtimin hapësinor. Nga intervistat e kryera, me aktorë vendimmarrës, identifikohet se ndërtimet janë realizuar jashtë çdo kontrolli urban, duke krijuar lagje pa qasje të lehtë në rrugë, ndriçim, sheshe publike dhe shkolla të afërta, gjë e cila ka çuar në përforcimin e ndarjes mes “qytetit të organizuar” dhe “periferisë së vetëmbijetuar”. Nga ana tjetër, dëshmohet se zonat rurale nuk kanë qenë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në projektet madhore infrastrukturore të Bashkisë Tiranë. Kjo mospërfshirje shpreh qartë se ndërtimi i një modeli gjithëpërfshirës urban, në zonat rurale nuk ka ndodhur ende. Aktorë të administratës vendore theksojnë se shumë banorë nuk përfitojnë dot nga shërbimet publike, edhe për shkak të mungesës së adresave të vendbanimeve të regjistruara jo në mënyrën e duhur, problemeve me certifikatat e pronësisë, apo të papunësisë joformale. E njëjta situatë reflektohet edhe në sistemin e sigurimeve shoqërore, ku shumë qytetarë nuk kanë dokumentim të punësimit të tyre në të kaluarën dhe si rrjedhojë nuk përfitojnë pensione apo ndihmë ekonomike. Pabarazitë urbane dhe rurale nuk janë më thjesht çështje qendre apo periferie, por ekzistojnë edhe brenda vetë territoreve

me të njëjtën tipologji, mbase në forma pak më të zbehta, por me pasoja po aq të thella. Për të përmirësuar situatën, është e domosdoshme të ndërhyhet me politika të fokusuara, të cilat të përfshijnë zhvillimin e territoreve, shtimin e hapësirave të gjelbra publike dhe këndeve të lojërave, përmirësimin e ndriçimit dhe infrastrukturës rrugore, si dhe rritjen e aksesit në shërbimet publike cilësore (arsim, shëndetësi, transport publik). Këto investime nuk janë vetëm estetike apo praktike, por përfaqësojnë një domosdoshmëri për të ndërtuar një territor me zhvillim të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për të gjithë banorët. Nga ana tjetër nuk mund të evidentojmë vetëm nevojat e përmirësimit të infrastrukturës fizike, por edhe ndërhyrjet që duhen bërë në sistemin social dhe ekonomik për popullsinë banuese si në zonat rurale ashtu edhe në zonat urbane. Në këtë kuadër, do të konsiderohej pozitive nëse do të merreshin masa për ngritjen e politikave të duhura për zhvillime të balancuara territoriale si nxitja e politikave lokale për punësim rural, sidomos për të rinjtë dhe gratë, investime të qëndrueshme në infrastrukturë, transport dhe shërbime publike, transparencë në vendimmarrje, mbështetje për familjet në nevojë dhe parandalim të braktisjes së shkollave, zhvillimin e turizmit dhe shërbimeve si sektorë me potenciale të larta, legalizimin e objekteve në zhvillimin e zonave periferike.

Përfundime

Brenda territorit të bashkisë Tiranë disbalancat socio – ekonomike janë mjaft të dukshme. Zonat rurale të Bashkisë Tiranë përballen me një shkallë më të ulët arsimimi në të gjitha nivelet, veçanërisht në arsimin e mesëm dhe të lartë, krahasuar me zonën urbane. Së pari, vihet re një hendek i theksuar në nivelin e arsimimit midis zonave urbane dhe atyre rurale. Përqindja e individëve me arsim universitar në zonat urbane është dy herë më e lartë sesa në zonat rurale, gjë e cila dëshmon për mundësitë më të shumta që ofron qyteti në lidhje me arsimin e lartë. Nga ana tjetër, zonat rurale karakterizohen nga një përqindje e lartë e popullsisë që mbyll arsimin vetëm në nivelin 9-vjeçar dhe një pjesë jo e vogël ka mbetur vetëm me arsim fillor. Një tjetër element shqetësues është prania më e lartë e individëve me arsim të ulët në zonat rurale krahasuar me zonën urbane. Kjo gjendje jo vetëm që evidenton mungesë aksesibiliteti dhe cilësie në shërbimet arsimore, por rrezikon të riprodhojë pabarazitë sociale dhe ekonomike në planin afatgjatë. Për të adresuar këto probleme, rekomandohet një ndërhyrje e qëndrueshme në politikat arsimore në zonat rurale. Së pari, është thelbësore zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore në këto zona, veçanërisht për arsimin e mesëm dhe atë profesional. Krijimi i kurseve të formimit profesional dhe mundësive për rikualifikim të fuqisë punëtore, në zonat rurale kryesisht, do të ndihmonte në rritjen e përfshirjes në tregun e punës. Gjithashtu, ofrimi i

transportit të sigurt dhe të përditshëm për nxënësit që jetojnë larg institucioneve arsimore do të ndikonte në reduktimin e braktisjes së shkollës. Është e rëndësishme që politikat të synojnë edhe mbështetjen sociale dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e arsimit. Këto ndërhyrje duhet të ndërtohen përmes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, institucioneve arsimore, organizatave joqeveritare dhe popullsisë lokale.

Nga puna në terren është identifikuar gjithashtu se disa nga problematikat kryesore janë informaliteti, mungesa e çerdheve dhe kopshteve bazuar në numrin e popullsisë, pamundësitë ekonomike, pamjaftueshmëria e të mirave materiale, etj. Nisur nga anketat me banorët, por edhe me aktorët vendimmarrës, vihen re këndvështrime të ndryshme se si territori shihet. Por, çfarë duhet përmirësuar? Duhet të nxiten investimet e duhura me qëllim që të ulet numri i të papunësisë, të zgjerohen godinat e shërbimit shëndetësor dhe popullsia të mbulohet me shërbimin e duhur, të rriten kapacitetet dhe stafi shëndetësor i specializuar, të subvencionohen fermerët që janë të angazhuar në bujqësi, të rritet bashkëpunimi institucion-popullsi lokale, të mbështetet ajo kategori e individëve që kanë nevoja të veçanta, apo çdo planifikim tjetër që zbeh pabarazitë socio-ekonomike dhe përjashtimin hapësinor.

Bibliografia

1. Akram. S, Pervaiz. Z, *Estimation of inequality of opportunities across countries: a multidimensional approach*, Studies in Economics and Econometrics, 48(1), 18–41, 2024
2. Akram. S, Pervaiz. Z, *Multidimensional inequality, social cohesion, and economic growth*, J. Soc. Econ. Dev, 2025, <https://doi.org/10.1007/s40847-025-00436-x>
3. Batur. S, “*Center and Periphery*”, Encyclopedia of Critical Psychology, Springer, New York, 2014, https://doi.org/10.1007/978-1-4614-5583-7_37
4. Bourdieu P., Wacquant L.J.D., *Zaproszenie do socjologii refleksyjnej*, Warszawa: Oficyna Naukowa, 2001
5. Fainstein. S, *The just city*, Cornell University Press, pg. 57, 2010, https://books.google.al/books?vid=ISBN9780801462184&printsec=index&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false
6. Ferreira. FH, Lakner. C, Lugo. MA, Özler. B, *Inequality of opportunity and economic growth: how much can cross-country regressions really tell us?* Incom Wealth 64(4), 800–827, 2018
7. Harvey. D, *Social justice and the city*, University of Georgia Press, 1973, <https://www.encyclopedia.com/social-sciences/applied-and-social-sciences-magazines/harvey-david>
8. Kyloušek. P, *What is the center and what is the periphery?*, *Centers and Peripheries in Romance Language Literatures in the Americas and Africa*, Studies in Comparative Literature, Vol. 105, 2024, pg. 17 – 42, ISBN: 9789004691131, https://doi.org/10.1163/9789004691131_003
9. Lefebvre. H, *The production of space*, Blackwell Publishing. pg. 68 (Original work published 1974), 1991 <https://iberian-connections.yale.edu/wp-content/uploads/2020/04/The-production-of-space-by-Henri-Lefebvre-translated-by-Donald-Nicholson-Smith.pdf>
10. Lipset S.M., Rokkan S., *Cleavage structures, party systems, and voter alignments: an introduction*, Party Systems and Voter Alignments, New York, 1967
11. Mao. D, Chen. J, Hu. S, *Urban-rural economic inequality: is social entrepreneurship the solution?*, China Agricultural Economic Review, 2025, <https://doi.org/10.1108/CAER-12-2023-0371>
12. Marcuse. P, *From Critical Urban Theory to the Right to the City*, City 13 (2–3), 185–97, 2009, <https://doi.org/10.1080/13604810902982177>
13. Marku. B, *Urban development challenges in transition: The case of Tirana*. European Journal of Geography, 6(2), 45-58, 2015,

https://www.researchgate.net/publication/339553192_TIRANA_the_Challenge_of_Urban_Development

14. Marrero. GA, Rodríguez. JG, *Inequality of opportunity in Europe*, Income Wealth 58(4), 597–621, 2012, <https://doi.org/10.1111/j.1475-4991.2012.00496.x>
15. Naydenov. K, *Social and economic inequality as a brake on effective environmental policy*, Economics of Sustainability and Environmental Policies, Vol. 24, 2025, DOI: [10.5593/sgem2024v/4.2/s20.57g](https://doi.org/10.5593/sgem2024v/4.2/s20.57g)
16. Tóth. G, Wachs. J, et al., *Inequality is rising where social network segregation interacts with urban topology*, Nature Communications, 2019, <https://doi.org/10.1038/s41467-021-21465-0>, https://www.researchgate.net/publication/336059312_Inequality_is_rising_where_social_network_segregation_interacts_with_urban_topology

**RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE
NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN, RAST
STUDIMI “DURRËSI”
*THE PRESERVATION OF BUILT AND ARCHAEOLOGICAL HERITAGE
IN THE CONTEXT OF RAPID URBAN DEVELOPMENT, A CASE STUDY
OF DURRËS***

PhD.Cand. MARSIDA GOREA

mgorea@umt.edu.al

Prof. Dr. ROMEO HANXHARI

Universiteti i Tiranës

romeo.hanxhari@unitir.edu.al

Abstrakt

Qyteti i Durrës/Epitamn është themeluar në shek. VII p.e.s. si një nyje e rëndësishme komunikimi në Adriatik, Mesdhe e më tej në zonat kontinentale. I konsideruar si “portë hyrëse e Orientit”, qyteti u dizenua si pikënisje e rrugës Egnatia, mbi gjurmët e së cilës sot kalon korridori paneuropian VIII. Ky pozicion i rëndësishëm strategjik ka sjellë që në Durrësin e sotëm, të banuar në mënyrë të vazhdueshme për 2700 vite, të shtresëzohen nën e mbi tokë gjurmë të kulturave të ndryshme: ilire/arbërore/shqiptare, greke, romake, bizantine, normane, veneciane, osmane, italiane, e më gjerë. Në 35 vitet e fundit qyteti ka pësuar një ndryshim të vrullshëm, kryesisht ndërtimor, dhe përgjithësisht të mbështetur në studime urbane pjesore e jo në plane të gjera territoriale. Kryefjalë e këtij “zhvillimi”, përtej “modernizimit” të peizazhit urban, ka qenë zbulimi rastësor i gjurmëve arkeologjike të nëntokës dhe sfidat për ekuilibrimin e nevojave moderne me mbrojtjen e trashëgimisë së ndërtuar dhe arkeologjike. Ky studim, që është pjesë e një kërkimi të nivelit doktorat, synon që nëpërmjet analizës së zhvillimeve të fundit, zbulimeve arkeologjike që i kanë pasuar, legjislacionit, dokumenteve të planifikimit në fuqi mbi këtë territor dhe problematikave të hasura gjatë këtyre viteve, të japë përfundime e rekomandime lidhur me planifikimin e ruajtjes së trashëgimisë së ndërtuar dhe rivlerësimin e saj.

Fjalë Kyçe: planifikim, rivlerësim, ruajtje, trashëgimi, zhvillim urban;

Abstract

The city of Durrës/Epidamn was founded in the 7th century BC as an important communication hub in the Adriatic and Mediterranean and their continental areas. Considered the “gateway to the Orient”, the city was later designed as the starting point of the Egnatia road, on whose tracks the Pan-European Corridor VIII now runs. This important strategic position has led to the stratification of traces of different cultures in this territory, continuously inhabited for 2700 years: Illyrian/Arbër/Albanian, Greek, Roman, Norman, Venetian, Ottoman, and beyond. In the last 35 years, the city has undergone a rapid change, mainly construction-related, and generally based on partial urban studies and not on extensive territorial plans. The keynote of this “development”, beyond the “modernization” of the urban landscape, has been the accidental discovery of archaeological traces of the underground. The preservation of the built cultural heritage and in particular of new archaeological finds, has constituted the greatest challenge facing the economic and urban development of the city. This study, which is part of a doctoral research, aims to provide conclusions and recommendations regarding the planning of the preservation of the built heritage and its enhancement, through the analysis of recent developments, subsequent archaeological discoveries, legislation, planning documents in force on this territory and the problems encountered during these years.

Keywords: *planning; reassessment; preservation; cultural heritage; urban development;*

1. Historia e qytetit

Dyrrachion ishte një qendër e lulëzuar botës antike, e banuar në mënyrë të vazhdueshme që nga themelimi. Qyteti në antikitet ishte një pike e rëndësishme e kryqëzimit të itinerareve të ndryshme kulturore e tregtare drejt qyteteve të Adriatikut, kolonive greke dhe qendrave të tjera në brendësi të Ballkanit.

Sipas burimeve historike të njohura sot qyteti ka njohur kulmin e zhvillimit gjatë Perandorisë Romake e më vonë gjatë Perandorisë së Bizantit. Këtë e provojnë gjurmët e shumta arkeologjike të veprave publike e private, me të cilat nëntoka e qytetit është aq e pasur. Ndër objektet e trashëgimisë së ndërtuar në qytet mund të veçojmë amfiteatrin romak me kapacitet rreth 20.000 spektatorë (shek. II e.s.), termat (shek. I e.s.), ujësjellësin romak (shek II e.s.), fortifikimet bizantine (shek. V-VI e.s.), nekropolin (shek. VI –I p.e.s.) dhe torrën veneciane (shek. XV e.s.). Të gjitha këto objekte arkitekturore dhe gjetjet arkeologjike

dëshmojnë dimensionin dhe rëndësinë e qytetit në antikitetin e hershëm dhe të vonë, si dhe në mesjetë.




fig. 1. Situata e hershme gjeografike e Durrësit, E. Shehi.



fig. 2 Hartë e zhvillimit antik të Dyrrachium dhe lagunës pranë tij, Praschniker& Schober, 1919.

Zhvillimi i urban do të frenohej me pushtimin osman më 1501, që në Durrës u vendos pas gjithë qyteteve të tjera shqiptare. Në katër shekujt e sundimit osman qyteti, banesat e tij dhe ndërtesat e pakta publike u zhvilluan më së shumti brenda mureve të kalasë. Durrësi, nga një qytet i prirur në zhvillimin e marrëdhënieve detare u turr në kufijtë e përcaktuar nga muret bizantine. Nukli urban në këtë kohë ruajti fizionominë origjinale ishullore, i kufizuar nga deti në perëndim, veri dhe jug dhe nga këna e Durrësit në lindje.



fig. 3 Pikturë që paraqet peisazhin e Durrësit me muret rrethuese të kalasë gjate periudhës Osmane, 11 Tetor 1848, Edward Lear, 1851.

Fillimi i shek. XX shënoi një epokë të re për qytetin, me zhvillim të ri urban, por edhe me rizbulimin e trashëgimisë antike. Ndërtimi vijoi jashtë mureve rrethuese, me godina të reja avangard në stil neoklasik. Arkitektët italianë L. Carmignani e F. Poggi hartuan këtë kohë Planin Rregullues të qytetit në përputhje me parimet bashkëkohore të Restaurimit Filologjik në orientimin e zhvillimeve të reja në raport me qytetin historik, sipas modelit teorik që aplikohet asokohe në situatat analoge në Itali.

Plani parashikonte vendosjen e ndërtesave të reja në harmoni me qytetin ekzistues otoman, ku realizoheshin vetëm prishje pikësore¹⁸ për t'i bërë vend institucioneve publike si Bashkia dhe Banka Kombëtare¹⁹. Zonat e reja lidheshin me lagjet otomane mes zgjatimit dhe përforcimit të akseve rrugore ekzistuese që kryqëzoheshin në trajtën karakteristike “Y”. Kjo fazë e re zhvillimi gjeneroi një sërë arkitekturash me vlera të spikatura, që në vitet në vijim kanë marrë statusin monumente kulture.

¹⁸Shiko G. Giovannoni, Teknika e “*Diradamento*” e cila ruan pëlhurën urbane historike duke pranuar vetëm prishje të vogla pikësore, përkundërt çarjes së akseve të reja rrugore mes qytetit historik;




fig. 4 Plani Rregullues i Durrësit, 1942, Plani i Zonimit e Bonifikimit, Ufficio centrale per l'Edilizia e l'Urbanistica dell'Albania, L. Carmignani, F. Poggi.

Përfundimi i Luftës Botërore II solli instaurimin e diktaturës komuniste dhe zhvillimin e centralizuar ekonomik e urban. Në këto vite u realizua tharja e kënetës, nisur që para luftës së Dytë Botërore, dhe si rrjedhojë edhe rikonfigurimi territorial i qytetit, i cili humbet trajtën ishullore dhe krijon vazhdimësi fizike me sipërfaqet e territorit përreth. Kripësia e tokave të kënetës nuk lejoi që ato të përdreshin për bujqësi, por ato u destinuan për zona industriale dhe deri diku rezidenciale. Ndërtimet e reja gjatë periudhës komuniste vijuan sipas blloqeve të rregullta urbane me parametrat dhe estetikën e arkitekturës brutaliste të realizmit socialist. Rënia e diktaturës në 1990 e ktheu sërish Durrësin në teatër ndryshimesh të mëdha kaotike. Tranzicioni drejt pluralizmit dhe ekonomisë së lirë solli lëvizje të mëdha demografike drejt qytetit port më të madh në vend, ndërsa plazhet e gjëra ranore e bënë atë atraktiv për zhvillimin e turizmit detar. Zhvillimi i vrullshëm konfirmoi industrinë e ndërtimit si degë kryesore të ekonomisë lokale, duke sjellë përtej kaosit urban, mungesën e infrastrukturës publike dhe dëme të konsiderueshme sa i përket pasurive arkeologjike të qytetit, shumica e të cilave janë mbyllur nën peshën e betonit.

2. Zbulimet arkeologjike, mes ruajtjes dhe shkatërrimit

Zbulimi i qytetit antik të Durrësit mund tëshikohet i ndarë në tre faza kryesore. Fillesat e studimit të monumenteve dhe zbulimeve arkeologjike i takojnë gjysmës së parë të shekullit të XX nga ekspertë të huaj kryesisht gjermanë e italianë. Shkëputja e Shqipërisë nga Perandoria Osmane solli hapjen e vendit dhe rritjen e interesit ndaj arkitekturës dhe arkeologjisë së tij si pjesë e basenit të kulturës antike greko romake, që kish ngjallur shumë interes prej fillimit të shek. XIX. Qyteti i Durrësit asokohe me trajtë ishullore kufizohej nga muret masive të kalasë bizantine, brenda së cilës zhvillohej një pëlhurë e dendur otomane. Muret e gjera bizantine (shiko fig. 3) përbënin tiparin dallues të qytetit dhe njëkohësisht të vetmen trashëgimi arkeologjike të dukshme, ndërsa rrënojat antike flinin nën qytetin ekzistues e territoret natyrore përreth.




fig. 5 Harta e zbulimeve arkeologjike në Durrës, Leon Rey 1925²⁰

Shtresëzimet e pasura antike ngjallën në fillimin e ‘900 interesin e studiuesve të huaj si Léon Rey, Praschniker e Ugolini, puna e të cilëve kontribuoi në njohjen dhe rritjen e interesit për arkeologjinë e Dyrrahiumit²¹.

Duhet theksuar se ndërsa zbulimet e izoluara nga arkeologjia greko romake gëzonin interes të vecantë.²², trashëgimia bizantine e otomane nuk vlerësohej njëlloj. Këtë kohë u prishën objekte të ndryshme arkeologjike si Bastioni i madh i kalasë bizantine pranë kishës ortodokse të Shën Spiridhonit, i cili i bëri vend ndërtesës së re të Bankes së Shqipërisë. Ndërtesa të tjera si Konaku, apo ish rezidenca e Princ Vidit, dëmtuar gjatë Luftës së Parë Botërore, u prishën për t’u lënë vendin të reja.

²⁰Léon Rey, Rey 1925 a, Rey 1925 b

²¹Archeologia urbana a Durres, Santoro

²²Shembull është zbulimi i mozaikut Bukuroshja e Durrësit gjatë punimeve rrugore nga arkeologu austriak C. Praschniker në vitin 1918.




fig. 6 Bastioni i madh i Kalasë së Durrësit i prishur në vitet '30 për të ndërtuar godinën e Bankës, në krah kisha e Shën Spiridhonit prishur gjatë viteve të komunizmit.



fig. 7 Foto e vitit 1916, Konaku apo rezidenca e Princ Vidit, Durrës, Arkiva Digjitale Shqiptare

Faza e dytë e zbulimit përkon me periudhën e regjimit komunist dhe me afirmimin e indentitetit dhe lashësisë kombëtare. Më 1948 u hartua lista e pare e monumenteve dhe falë punës sistematike të instituteve dhe ekspertëve pranë tyre u vijua me evidentimin e pasurive të tjera ndërtimore dhe zbulimeve të reja arkeologjike.

Në vitet '60-'90 u zhvilluan fushata sistematike të gërmimit me rezultat zbulimin e shumë objekteve arkeologjike të paçmueshme si forumi romak, nekropoli, etj... Në 1966, një ekip arkeologësh drejtuar nga Vangjel Toçi zbuloi amfiteatrën romak, i cili me kapacitetin e tij prej afro 20.000 spektatorësh do të

hidhte dritë mbi popullatën e qytetit antik e për pasojë rendësinë e Dyrrahiumit duke tërhequr sërish vëmendjen e studiuesve për shtresëzimet antike, që me gjasa kishin shtrirje shumë herë më të gjerë se qyteti modern i kohës.

Objektet më të rëndësishme arkeologjike që sot ruhen nga ligjet e shtetit si monumente të trashëgimisë kulturore të kategorisë (I) janë zbuluar gjatë viteve të diktaturës. Në këtë kohë, realizimi i zbulimeve, por edhe shpronësimi i trojeve për të mundësuar gërmime të përmasave të qënësishme ishte më i thjeshtë si pasojë e shtetëzimit të të gjitha pronave dhe mungesës së sipërmarrjes private. Duhet theksuar se në këtë periudhë krahas zbulimeve, në kuadër të Revolucionit Kulturor u shkatërruan shumë pasuri kulturore të lidhura me kultin si Kisha e Shën Spiridhonit, Manastiri i Shën Vlashit, etj...

Zbulime të tjera në vitet '60-'80 patën karakter rastësor, si rasti i kompleksit të termave publike romake gjatë punimeve për ndërtimin e Pallatit të Kulturës "A. Moisiu" më 1960. Në këtë rast, për të mos penguar implementimin e investimit publik u aplikua për herë të parë zgjidhja e "muzeut arkeologjik nën një ndërtim të ri".

Terma të tjera private bashkë me mozaikun me figura detare erdhen në dritë gjatë punimeve për ndërtimin e një pallati banimi në vitin 1987 në lagjen nr.6.

Faza e tretë e zbulimeve përkon me periudhën e tranzicionit postkomunist, i cili e gjeti vendin të papërgatitur në aspektin legjislativ e institucional për të trajtuar çështjet e lidhura me ruajtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin e territorit.



fig. 8 Amfiteatri i Durrësit, foto gjatë gërmimeve të zbulimit në vitin 1966 nga arkeologu Vangjel Toçi.




fig. 9.1 Foto ilustruese e termave nën pallatin e kulturës A. Mosiu gjatë gërmimit²³, FOTO Lida Miraj

fig. 1.2 Foto e termave romake nën pallatin e kulturës, Durrës.

3. Aktet ligjore dhe dokumentet e planifikimit mbi ruajtjen e trashëgimisë së Durrësit

Ligji Nr.9048/2003 “Për trashëgiminë kulturore” vuri Bashkinë Durrës para detyrimit për të përcaktuar dhe miratuar kufijtë e zonës arkeologjike brenda qendrës së banuar.

Misioni Arkeologjik Italian, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Arkeologjisë, hartoi të njëjtin vit “Kartën e Rrezikut Arkeologjik të Durrësit” të mbështetur në modelet e kartave të rrezikut arkeologjik të qyteteve italiane e

europiane. Ky dokument vendosi në një hartë të vetme çdo gjetje arkeologjike të rilevuar deri në atë kohë, duke krijuar një bazë shumë të mirë hartografike për të gjitha instrumentet e planifikimit të territorit dhe ruajtjes së trashëgimisë së qytetit.

Në vitin 2018, mbështetur në Kartën e Riskut Arkeologjik (2003) u miratuan kufijtë e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre²⁴.

Kufijtë e zonave arkeologjike “A” dhe “B” paraqiten me koordinatat të përcaktuara saktë sipas sistemit Gis. Në rregullore ndalohen ndërtimet e reja në zonën arkeologjike “A”, ndërsa në zonën “B” lejohen ndërtimet e reja vetëm pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).

Tërmeti i vitit 2019 shkaktoi dëme të mëdha në objektet e trashëgimisë së ndërtuar, Për rekuperimin e këtyre dëmeve brenda zonës arkeologjike “A” u hartua Plani i Detyruar Vendor (PdyV)²⁵, i cili parashikon një sërë ndërhyrjesh çliruese rreth Amfiteatrit si dhe krijimin e një parku të gjelbër urban.

²⁴VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”

²⁵PdyV për zonën e re për Zhvillim, Zona 5, Njësia Administrative Durrës, V. K.B. nr. 39, dt. 19.05.2021, Son Architect;

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E
ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI”




fig. 2 harta e Rrezikut Arkeologjik të Durrësit, Misioni Arkeologjik Italian, 2003




fig. 3 Zonat e mbrojtura arkeologjike A dhe B të Durrësit brenda kontekstit urban

Ky koncept më tej do të detajohej në vitin 2022 në projektin “DURRËS ARCHAEOLOGICAL PARK”²⁶.

Këto instrumenta përbëjnë një hap pozitiv në raport me rivlerësimin dhe rijetësimin e trashëgimisë arkeologjike të Durrësit, por mbeten të kufizuara në hapësirë e kohë. Territoret e propozuara si pjesë e itinerarit të parkut arkeologjik janë vetëm ato të zbuluara gjatë regjimit. Rrënojat e zbuluara pas viteve '90 nuk integrohen në asnjë nga itineraret e parkut.

²⁶ “Durrës Archaeological Park”, Projekt istudios ndërkombëtare Stefano Boeri Architects në bashkëpunim me partnerin lokal SON Architects;

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI”






Fig. 6 Durrës Archeological Park, Stefano Boeri Architect, 2022

Të njëjtin vit u miratua dhe Plani i Përgjithshëm i Vendor i Durrësit²⁷ ku përsëriten të njëjtat detyrime ligjore mbi zonat e mbrojtura “A” dhe “B” të qytetit.

Në vitin 2023 zonat arkeologjike "A" dhe "B" do të pajiseshin me një Plan Menaxhimi²⁸ për periudhën 2023-2030. Ky plan, pas një analize të detajuar të qytetit, propozon masa për ruajtjen dhe provimin trashëgimisë kulturore, si dhe jep sugjerime për rishikimin dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura edhe kundrejt territoreve nënujore²⁹.

Ndër instrumentat e propozuar për periudhën afatshkurtër është krijimi i pesë itenerareve turistike brenda territorit urban, të cilat do të mundësojnë njohjen dhe promovimin e historisë të qytetit.

²⁷PPV I Bashkisë Durrës, Vendim nr. 4, dt. 27.07.2022 I Këshillit Kombëtar të Territorit;

²⁸Plani I Menaxhimit të zonave Arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit për periudhën 2023-2030, VKM nr.831/2023, ARS Progetti S.P.A, Romë, Itali;

²⁹Sipas rekomandimeve të Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2009;

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI”



Projekte në vazhdim
Itinerari 01 (Nga bregdeti deri në Pallatin e Mbretit Zog)
Itinerari 02 (Nga fortifikimi i poshtëm deri në Amfiteatrin Romak)
Itinerari 03 (Nga Sheshi Iliria deri në Memorialin e Luftës së Dytë Botërore)
Itinerari 04 (Nga Banka Kombëtare deri në Parkun linear të Fortifikimit të Poshtëm)
Itinerari 05 (Nga Pallati i Mbretit Zog deri tek Fari)

fig. 7 Projekti i itinerareve urbane, Plani i Menaxhimit të Integruar i Zonave Arkeologjike A & B të Qytetit të Durrës 2021-2028

Në fund të vitit 2024 zona arkeologjike e mbrojtur do të zgjerohet në det duke marrë statusin “Pasuri Kulturore”³⁰. Terrioter arkeologjike nënujore do të klasifikohen njësoj si ajo urbane në zonën “A”, ku lejohet vetëm kryerja e hulumtimeve shkencore dhe muzealizimi i mbetjeve arkeologjike, dhe në zonën

³⁰VKM nr. 850/2024 “Për deklarimin “Pasuri Kulturore” të Zonave Arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”

“B”, ku lejohen edhe zhvillimet e reja pas miratimit nga KKTKM³¹.



fig. 8 Harta e Zonave Arkeologjike Nënujore të Qytetit të Durrësit, 2024

4. Sfidat aktuale mes ndërtimit të qytetit të ri dhe ruajtjes së trashëgimisë

Gërmimet për ndërtimin e strukturave private e publike pas vitit 1990 kanë nxjerrë thuajse gjithmonë në sipërfaqe rrënoja të tipit arkeologjik.

Në vijim do të analizojmë disa zhvillime të realizuara në Durrës gjatë dy dekadave të fundit, zbulimet arkeologjike që i kanë pasuar dhe zgjidhjet e adaptuara për ruajtjen e tyre.

Rasti i parë që do të marrim në shqyrtim është ai i “Godinë banimi dhe Shërbime, 6-kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, pranë Ish Lulishtes “1 Maji” në Durrës.

Sheshi i ndërtimit gjendej brenda kufirit të zonës arkeologjike “B”, referuar kartës së riskut arkeologjik të qytetit. Gërmimet me thellësi 6m nga kuota e trotuarit të “Bulevardit Kryesor” do të sillnin në dritë pjesë të një “Lagjie zejtare” të periudhës romake (shek. II e.s.). Rrënojat arkeologjike fillimisht u mbajtën të fshehura nga firma zbatuese e projektit, por në vijim lajmi u bë publik e pati

³¹Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale

jehonë të gjërë mediatike. Punimet për ndërtimin e ri u ndërprejnë përkohësisht me vendim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA), me qëllim realizimin e gërmimeve arkeologjike të shpëtimit dhe dokumentimin e përmbajtjes së nëntokës³². Raporti i ASHA³³ evidenton që kemi të bëjmë me një lagje romake “intra muros” apo brenda mureve rrethuese të qytetit, me shtresëzime të ndryshme deri në periudhën bizantine.




fig. 9, fig. 10 Foto të gërmimeve arkeologjike pranë ish Lulishtes “1 Maji” në Durrës, viti 2010

³²Vendimi nr. 15, dt.18.03.2010 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)

³³Propozime ne perfundim te germimit te shpetimit arkeologjik ne siperfaqen e ndertimit: 2010/59/1 (XHEMF), Lagja 11, rruga Prokop Meksi ne Durres, ASHA,




fig. 11 Planimetri e gjetjeve arkeologjike në kuotën +/-0.00m, nga “Projekt – Ideja mbi trajtimin e strukturës arkeologjike që do të ruhet me konstruksion beton/arme në objekt” ,”A.K.e R.” Sh.p.k.

Propozimi i dhënë nga ASHA e më pas i miratuar me vendim të KKA, do të ishte ai i pezullimit të mëtejshëm të gërmimeve, “traslocimi-t” të disa gjetjeve arkeologjike të lëvizëshme si mozaiku apo pajisjet zejtare për punimin e qelqit me qëllim muzealizimin e tyre. Gjetjet arkeologjike të palëvizëshme do të muzealizoheshin në katin (-1) të godinës së banimit që do vijonte të ndërtohej sipas lejes së rishikuar “Godinë Polifunksionale dhe Muze Arkeologjik”³⁴. Rasti i lulishtes “1 Maji” ilustron më së miri shembujt e shumë pallateve shumëkatëshe ndërtuar këto vite në terrene me rrenoja arkeologjike, ku sipas të njëjtës logjikë e procedurë rrënojat arkeologjike do mbyllen brenda një podrumi praktikisht të paaksesueshën nga qytetarët e turistët (shiko fig. 14).

³⁴Vendimi Nr. 96, dt. 07.07.2010 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)




fig. 12 Evidentimi i strukturave arkeologjike të muzealizuara nën ndërtesa moderne (të qarkuara), mbi Hartën e Strukturave të dukshme arkeologjike në Durrës, Misioni Arkeologjik Franko-Shqiptar;

Jo vetëm investimet private, por edhe ato publike kanë rënë shpesh ndesh me konservimin e trashëgimisë arkeologjike të Durrësit. Shembulli që mund të sqarojë më mirë këtë rast është projekti “Veliera”.

Projekti i studios ndërkombëtare të arkitekturës ARCHEA, porositur nga Bashkia Durrës kishte në fokus zgjidhjen e kryqëzimit mes Bulevardit Epidamn dhe Rrugës Egnatia, lehtësimin e kalimit të këmbësorëve drejt bregdetit nëpërmjet një sheshi tërësisht pedonal si dhe krijimin e një landmarku me arkitekturë moderne në qytet. Fluksi i makinave do të kanalizohet në nënkalimin e vendosur nën shesh.




fig. 13 Planimetri e projektit të Sheshit Veliera, ARCHEA ASSOCIATI, 2016

fig. 14 Foto të sheshit Veliera dhe gërmimeve brenda zonës arkeologjike “A” në fazën e pezullimit të punimeve, foto Gëzim Kabashi, 2017

Realizimi i nënkalimit në hapësirën mes Torrës Veneciane në Perëndim dhe fragmentit të murit bizantin në Lindje, implikonte gërmime të thella brenda zonës urbane të riskut arkeologjik ku mundësia për gjetje arkeologjike është e lartë, ndaj dhe nga viti 2018 nuk do lejohen ndërtime të reja³⁵ në të.

Struktura e tipit publik, pas marrjes së miratimeve përkatëse nga institucionet e linjës filloi të zbatohej në vitin 2016. Gjetja e rrënojave arkeologjike të bastionit iliriko-romak gjatë gërmimeve u bë lajm dhe solli nisjen e një procesi gjyqësor nga shoqëria civile, me pasojë pezullimin e punimeve për gati 2 vite për kryerjen e gërmimeve të shpëtimit.

Në fund të 2019, Gjykata e Durrësit, bazuar mbi mendimin teknik të

³⁵VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”

ekspertizës arkeologjike, vlerësoi se projekti i ndryshuar mundësonte ruajtjen e objekteve arkeologjike dhe ekspozimin e një pjese të tyre, duke lejuar vijimin e punimeve në kantierin Veliera.



fig. 15 Pamje ajrore e sheshit Veliera dhe gjetjeve arkeologjike gjatë punimeve në vitin 2018, ASIG GEOPORTAL



fig. 16 Pamje ajrore e sheshit Veliera, të evidentuara zonat arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, AKPT MAPS, 2025

Rindërtimi i Gjimnazit “Gjergj Kastrioti” një vit pas tërmetit të 2019-ës solli përsëri zbulimin arkeologjik të kompleksit të një vile romake (shek I e.s.). Sipërfaqja e përgjithëshme e vilës prej rreth 2500m², termat private, si dhe detajet

e pasura dekorative të afresqeve e mozaikëve konfirmojnë hipotezën e një rezidence patrice. Sheshi ndodhet në zonën e kodrës së Vilës, rreth 300 metra larg amfiteatrit, brenda kufijve të zonës arkeologjike “B”. Gjetjet kanë sjellë pezullimin e punimeve prej 5 vitesh, ndërsa rrënojat romake qëndrojnë të zbuluara nën efektin shkatërrues të agjentëve atmosferikë. Vonesa në vendimmarrjen e institucioneve për ruajtjen e tyre po sjell dëmtime të parekuperueshme në objektin arkeologjik.



fig. 17 Pamje nga sheshi i ndërtimit të Gjimazit “Gjergj Kastrioti” dhe gjetjeve arkeologjike, Durrës, foto Ballkanweb, 2019

Në vitin 2023, gjatë ndërtimit të portit të hidrokarbureve në Porto Romano, u dëmtua rëndë monumenti “Muret e Portës”³⁶, pjesë e sistemit fortifikues të qytetit, ndërtuar gjatë sundimit të perandorit Anastasi I. Ky objekt ishte evidentuar që herët nga arkeologët austriakë Praschniker dhe Schober, të cilët në vitin 1919 e përmendin me emërtimin “Porthes”³⁷ në shkrimet mbi kërkimet arkeologjike që kishin realizuar gjatë viteve të Luftës së I Botërore,.

Statusi Monument i Kategorisë (I), që sipas legjislacionit në fuqi detyron ruajtjen integrale të objektit, nuk ka shërbyer për ruajtjen e murit bizantin i cili ishte restauruar në 2018.



fig. 18 Portë me qemer në murin fortifikues të Portezës. Viti 1912, Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”.

³⁶Lista e Monumenteve të Kulturës - Qarku Durrës, NR. 6 MURET E PORTES (PORTO ROMANO) I Durrës Durrës 1. Vendim i Institutit i Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, dt. 16.10.1948); 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/vendim nr. 6/dt.15.01.1963; 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/dt.10.06.1973.

³⁷C. Praschniker, A. Schober, Wien 1919, f. 46.



fig. 19 Kantieri i ndërtimit të Portit të Hidrokarbureve në Porto Romano dhe monumenti “Muret e Portës”, AMFORA.AL

5. Problematikat

Karta e Riskut Arkeologjik të Durrësit që përpjekja e parë serioze për ruajtjen e trashëgimisë nëntokësore të qytetit. Ajo krijoi bazën për hartimin e ligjeve dhe planeve mbi mbrojtjen e nëntokës, duke mundësuar planifikimin e qëndrueshëm të zhvillimeve të reja. Gjithsesi, periudha e tejzgjatur 15-vjecare mes hartimit të këtij dokumenti me vlerë orientuese dhe miratimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit, pati si pasojë miratimin e shumë lejeve të ndërtimit brenda territoreve arkeologjike dhe dëmtimin e mëtejshëm të kësaj pasurie.

Nga ana tjetër, nëse mbivendosim Kartën e Riskut Arkeologjik (2003) me Hartën e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” mund të shikojmë disa mospërputhje.




fig. 20 Mbivendosje e hartës së zonave të mbrojtura Arkeologjike “A” (e kuqe) dhe “B”(blu) të Durrësit miratuar në 2018, me Kartën e Riskut Arkeologjik të Durrësit, hartuar nga Misioni Arkeologjik Italian më 2003;

Zonimi i vitit 2018 i referohet rrugëve ekzistuese të qytetit në përcaktimin e ndarjes mes zonave të mbrojtura, duke marrë disa kthesa të çrregullta në kufirin e zonës A, ku përjashtohen territore në favor të shesheve për zhvillim. Do kishte qenë më e arsyeshme që ndarja e dy zonave të riskut arkeologjik t’i referohej gjetjeve arkeologjike, akseve rrugore të qytetit antik apo fortifikimeve unazore

bizantine. Duhet theksuar se parcelat në vijën bregdetare nuk përfshihen brenda këtij zonimi, packa se edhe në këtë brez ka gjetje arkeologjike të dokumentuara (fig. 9).

Projekti “Durrës Archaeological Park” përbën gjithashtu një iniciativë pozitive lidhur me rikonfigurimin e kontekstit të pasurisë kulturore me qëllim promovimin e saj, por gjithcka mbetet e konturuar në zbulimet e para 1990-ës, periudhë kjo kur nuk ekzistonte prona dhe interesi privat. Zbulimet e tridhjetë viteve të fundit nuk përfshihen në këtë projekt, pasi me shumë gjasa janë zhdukur e betonuar edhe në rastet kur është vene kusht në leje për muzealizimin e tyre nën godina e reja shumëkatëshe.

Moment tjetër i rëndësishëm është miratimi i zonave arkeologjike nënujore në vitin 2024. Miratimi i kësaj zone të mbrojtur vjen si rekomandim i “Planit për menaxhimin e zonave Arkeologjike A dhe B të Durrësit”, ku sugjerohej zgjerimi i zonës së mbrojtur kundrejt detit, duke integruar edhe vijën bregdetare³⁸ të papërfshirë në zonat e mbrojtura arkeologjike të miratuara në vitin 2018.



fig. 21 Skema për zgjerimin e zonës arkeologjike të mbrojtur A dhe B për arkeologjinë nënujore, Plani për menaxhimin e integruar të zonave arkeologjike A dhe B të Durrësit, 2024

³⁸ Shiko “Plani për menaxhimin e integruar të zonave arkeologjike A dhe B të Durrësit”, fq 129

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI”

Në mbivendosjen e hartës së zonave arkeologjike urbane “A” dhe “B”, me hartën e zonave arkeologjike “A” dhe “B” nënujore të Durrësit vihet re se vija bregdetare, zona e Vollgës dhe në vecanti porti përbëjnë një hapësirë boshe apo shkëputje të vazhdimësisë brenda territoreve të mbrojtura arkeologjike të qytetit.



fig. 22 a,b Fragmente nga ortofoto e qytetit të Durrësit me zonat e mbrojtura arkeologjike mbitokësore e nënujore, ASIG, 2025

Në vrimën e zonës së mbrojtur qëndrojnë parcelat bregdetare përgjatë rrugës së re të portit ku së fundmi janë miratuar leje ndërtimi për kulla si Crown Plaza³⁹ (16 kate), apo Scalitur Tower⁴⁰ (19 kate), , etj...



fig. 23 Scalitur Tower, Luca Dini. 2025

fig. 24 Crown Plaza, FOCUS Architecture, 2023

Territori i portit gjithashtu është lënë jo rastësisht jashtë zonave të mbrojtura urbane e nënujore. Kjo sipërfaqe publike përkon me zonën e re për zhvillimin strategjik të “Durrës Yacht Marina”⁴¹, miratuar me ligj në vitin 2022.

³⁹Crown Paza Durrës, 2022, në fillim të shëtitores Taulantia

⁴⁰Scalitur Tower, 2025, Luca Dini Architects, Rruga e re e Portit, sheshi i parkimit mbas Bluestar;

⁴¹Ligjin 79/2022, “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, Sh.a. dhe Nshmi Development L.L.C për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË NDËRTUAR DHE ARKEOLOGJIKE NË KUSHTET E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM URBAN. RAST STUDIMI “DURRËSI”




fig. 25, a,b, Lagjia e re Durrës Yacht Marina, duresyachtsmarina.com, 2022

Ky investimi përfshin ndërtimin e rezidencave luksoze shumëkatëshe, objekteve komerciale, hotelerisë si dhe një marine për jahte.

Gjetja e mbetjeve arkeologjike të rastësishme, paçka se sipas ligjeve duhet të deklarohet e të ndiqen hapat përkatëse, mbetet më së shumti e fshehte. Hedhja e betonit në themelet e godinave të reja në Durrës bëhen shumë shpejt dhe shpesh

natën, për të fshirë cdo prove.

Vonesat në aprovimin e instrumentave për ruajtjen e trashëgimisë së ndërtuar, si dhe hapësirat ligjore në to e bëjnë shumë të vështirë mbrojtjen e territoreve me potencial arkeologjik. Këto territore përkojnë kryesisht me qendren e qytetit dhe vijën bregdetare, ndaj janë shumë të lakmuara për zhvillimet ndërtimore shkak edhe pozicioni në qytet si dhe rëndësia ekonomike e Durrësit.

Presioni i vazhdueshëm i investitorëve dhe zhvilluesve e ka bërë të pamundur pas '90 sjelljen në dritë të rrenojave arkeologjike dhe integrimin e tyre në iteneraret turistike të qytetit, sic mund të evidentohet edhe në planin për parkunm arkeologjik apo atë për menaxhimin e zonave "A" dhe "B".

Shumë pozitive konsiderohet angazhimi i vazhdueshëm i komunitetit qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë. Ky angazhim ama ka marrë refuzime të përsëritura nga institucionet, duke ulur besimin se zëri i komunitetit mund të dëgjohet. Një aspekt tjetër negativ është zëvendësimi i komunitetit të banorëve në zonat historike të qytetit, me rrjedhojë modernizimin e objekteve historike në vecanti dhe lagjeve tradicionale në tërësinë e tyre.

6. Rekomandime për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike të qytetit

Nëntoka e qytetit të Durrësit është parë gjithmonë si një problem dhe një e metë nga zhvilluesit dhe institucionet. Ndryshimi i këtij perceptimi është thelbësor në ruajtjen dhe promovimin e qytetit që fle mbi 3000 vite vlera historike të shtresëzuara. Zhvillimi i territorit duhet të kryhet në harmoni me trashëgiminë kulturore, arkeologjike dhe arkitektonike, duke ruajtur dhe rivlerësuar vlerat unike të kësaj trashëgimie.

Realizimi i këtij objektivi kërkon impenjim maksimal të institucioneve si dhe ndryshimin e përqasjes së tyre ndaj komunitetit, duke e parë përfshirjen e tij në proceset planifikuese si vlerë.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi nëpërmjet arsimit është i domosdoshme. Historia e arkitekturës së vendit tonë duhet të jetë pjesë e kurrikulave të shkollave 9-vjeçare e të mesme, në mënyrë që brezat e rinj të njohin e të mësojnë ta duan e ta mbrojnë trashëgiminë kulturore si aset dhe vlerë kombetare. *"...Garancia më e mirë për konserviminë monumenteve e i veprave të artit vjen nga dashuria dhe respekti i njerëzve dhe duhet pasur parasysh se këto ndjenja mund të favorizohet shumë nga një veprim i duhur i autoriteteve publike..."⁴²*

Përmirësimi i legjislacionit në fuqi mbi zonat e mbrojtura të Durrësit është i domosdoshëm. Duhet të eliminohen hapësirat për interpretime ligjore në favor të ndërtimit mbi site arkeologjike si dhe duhet të plotësohen hapësirat boshe brenda

⁴²Karta e Restaurimit të Athinës, 1931

zonave të mbrojtura, sic është sugjeruar edhe në planin për menaxhimin të tyre (2023).

Barra për ruajtjen e ndërtesave në zonat historike nuk duhet të bjerë vetëm mbi pronarët, të cilët duhen mbështetur me fonde të vecanta nga institucionet me qëllim konservimin e lagjeve tradicionale dhe nëntokës së tyre.

Nëntoka e qytetit dhe periferisë së tij duhet të studiohet nëpërmjet instrumentave moderne të investigimit arkeologjik si fotogrametria ajrore⁴³ për territoret rreth qytetit, dhe studimi gjeofizik e elektromagnetik në zonat urbane për të kuptuar strukturat e arkeologjike dhe thellësitë e tyre. Ky material do të ishte shumë i rëndësishëm në fazën paraprake të hartimit të planeve të detajuara dhe projekteve të ndryshme duke orientuar zhvillimin e qytetit.

Krijimi i një harte të plotë topografike të qytetit është i domosdoshëm për të kuptuar zhvillimin urban-topografik të qytetit, ndërsa bërja publike e saj për komunitetin do të sillte transparencë mbi sitet më të rëndësishme antike dhe ruajtjen e tyre;

Zhvillimi i qytetit të Durrësit duhet të orientohet sipas modeleve zhvillimore analoge të qyteteve me *shtresëzime të pasura arkeologjike si Roma, Athina, e qytete të tjera të mesdheut. Fenomene analoge, të neglizhimit të trashëgimisë arkeologjike në favor të zhvillimit të shpejtë urban, kanë ndodhur më parë edhe në qytete të tjera. Eksperiencat e këtyre vendeve mund të shërbejnë si bazë teorike dhe praktike për të zgjidhur problemet që aktualisht shqipëria dhe veçanërisht qyteti i Durrësit kanë në raport me ruajtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin e territorit.

Krijimi i parqeve arkeologjike të hapura e të aksesueshme është një risi pozitive, e cila duhet përkrahur e zgjeruar me site të tjera kulturore. Qyteti i ri duhet të respektojë karakterin dhe fizionominë e qytetit historik në ndërtesat reja, sidomos në afërsi të monumenteve antike.

Trashëgimia arkeologjike duhet të trajtohet si një nga shtyllat ekonomike të qytetit, e cila kontribuon jo vetëm në përforcimin e identitetit por edhe në zhvillimin e tij të ardhshëm.

⁴³Boni

7. Literatura e përdorur:

- Architetti e Ingegneri Italiani in Albania. Firenze: Edifir, 2012.
- Bonazzi, Achille, Gessica Bonini, Cristina Boschetti, Flavio Cecchini, Andrea Ghiretti, Paolo Giandebiaggi, Michele Di Filippo, et al. L'anfiteatro Romano di Durazzo: Studi e scavi 2004-2005, 2005.
- Bora, Maurizio, and Sara Santoro. In Progetto Durrës: Atti Del Secondo e Del Terzo Incontro Scientifico: Strumenti Della Salvaguardia Del Patrimonio Culturale: Carta Del Rischio Archeologico Catalogazione Informatizzata ESEMPI Italiani Ed Applicabilità in Albania, Villa Manin Di Passariano, Udine-Parma, 27-29 Marzo 2003: Alte Tecnologie Applicate All'Archeologia Di Durrës, 22 Giugno 2004. Trieste: Editreg, 2004.
- Frashëri, Gjergj. Illyrisches Dyrrah (Dyrrahu Ilir) Gjergj Frasheri. Tirana: Stiftung "Qendra Frasheri", 2015.
- Frashëri, Gjergj. Pasuria Arkeologjike e shqipërisë në rrezik: Studime, kritikë, reformë. Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria, 2014.
- Hidri, Hava, and Sali Hidri. Durrësi: Album historik. Tiranë: Ideart, 2006.
- Hidri, Hava, and Sali Hidri. Durrësi: Album historik. Tiranë: Ideart, 2006.
- Hurst, H. R. "Rescuing Durres (Dyrrachium) - Maurizio Buora e Sara Santoro (a Cura Di), Progetto Durrës. L'indagine Sui Beni Culturali Albanesi Dell'antichità e Del Medioevo: Tradizioni Di Studio a Confronto (Atti Del Primo Incontro Scientifico Parma-Udine, 19-20 Aprile 2002; EDITREG Srl, via Ugo Foscolo 26, Trieste 2003 = Antichità Altoadriatiche LIII). Pp. 375, 107 Black and White Ills., 15 Tavv. A Colori Fuori Testo. ISBN 88-88018-12-3. Euro 26." *Journal of Roman Archaeology* 18 (2005): 723–25. <https://doi.org/10.1017/s1047759400008011>.
- Karaiskaj, Gjerak. 5000 vjet fortifikime në shqipëri. Tiranë: Shtypshkronja "Pegi," 2016.
- Karaiskaj, Gjerak. 5000 vjet fortifikime në shqipëri. Tiranë: Shtypshkronja "Pegi," 2016.
- Lear, Edward. *Journals of a landscape painter in Albania*, &c. S.I.: LEGARE STREET PRESS, 2022.
- Miraj, Lida. "Mbishkrime Për Ndërtimet e Dyrrahut /Inscriptions Relatives Aux Constructions de Dyrrachium." *Iliria* 21, no. 1 (1991): 249–58. <https://doi.org/10.3406/iliri.1991.1592>.
- Miraj, Lida. "Termat e Dyrrahut / Les Thermes de Dyrrachion." *Iliria* 24, no. 1 (1994): 207–24. <https://doi.org/10.3406/iliri.1994.1638>.
- Muller, Arthur, and Fatos Tartari. "Durrës (Albanie). Les Terres Cuites Votives Du Sanctuaire de La Colline de Dautë." *Bulletin de correspondance hellénique* 131, no. 2 (2007): 1114–18. <https://doi.org/10.3406/bch.2007.7822>.

- Praschniker, Camillo, and Arnold Schober. *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro* Von Camillo Praschniker U. Arnold Schober. Wien: Hölder, 1919.
- Shehi, Eduard. “Rishikim MBI Topografinë e Durrësit Antik Në Dritën e Të Dhënave Të Reja Arkeologjiko-Historike / Review of the Ancient Durrës Topography in Light of the New Archaeological and Historical Data.” *Iliria* 41, no. 1 (2017): 71–131. <https://doi.org/10.3406/iliri.2017.2528>.
- Tagliamonte, Gianluca. In *Ricerche Archeologiche in Albania: Atti Dell’incontro Di Studi*, Cavallino-Lecce, 29-30 Aprile 2011. Roma: Aracne editrice S.r.l, 2014.
- Tartari, Fatos. *La Nécropole du ier-ive s C. de Notre ère À durrachium*. Durrës, 2004.
- Tartari, Fatos. “Monumente Funerare Të Shek. I-IV Të E. Sonë Nga Durrësi / Monuments Funéraires Des I-IV Siècles à Durrës.” *Iliria* 27, no. 1 (1997): 243–68. <https://doi.org/10.3406/iliri.1997.1681>.
- Tartari, Fatos. *Permbledhje artikujsh E studimesh*. Durrës: Shtëpia Botuese GEER, 2008.

**THE ALBANIAN QUESTION AND JAPAN: DIPLOMACY,
INTELLIGENCE ACTIVITIES, AND PUBLIC OPINIONS (1912–1922)⁴⁴****ÇËSHTJA SHQIPTARE DHE JAPONIA: DIPLOMACIA, AKTIVITETET E
INTELIGJENCËS DHE OPINIONE PUBLIKE (1912–1922)****NAKAZAWA TAKUYA**

Second Secretary, the Embassy of Japan in Albania

takuya.nakazawa-2@mofa.go.jp***Abstract:***

This paper studies Japan's response to the Albanian question, from Albania's declaration of independence to Japan's recognition of Albania as a state, based on diplomatic documents and the writings of intellectuals and officers in Japanese. This paper will elucidate that, regarding the Albanian question, not only Albanian delegates but also governments of Serbia and Greece lobbied for the support of the government of Japan, and that some Japanese diplomats supported the cession of Gjirokastrë, but that ultimately Japan supported independence and territorial integrity of Albania. In addition, in analyzing the discourses of intellectuals and officers, this paper referred to periodicals published not only in Tokyo but also in other regions and analyzed discourses on the Balkans in Japan at that time from various angles. This paper analyzes that Japanese intellectuals considered Albanians to be powerless and at the mercy of international politics, and at the same time, they had also harbored the prejudice that they were uncivilized people.

Keywords: Albania, Japan, diplomacy, Albanian Question, Balkanism

This paper analyzes early diplomacy of Japan regard on Albania, and how Japanese officers and intellectuals viewed Albania and Albanians during the 1910s.⁴⁵ Albania declared its independence from the Ottoman Empire in 1912, in

⁴⁴ The content of this paper is a personal opinion of the author and does not represent official views of the Ministry of Foreign Affairs of Japan or the Embassy of Japan in Albania.

⁴⁵ For the period other than the 1910s, see Iura Içiroo 井浦伊知郎, *Arubania intaanashonaru: Sakoku, mushinron, nezumikoo dake xha nakatta kuni o shiru tame no 45 kakoku* アルバニア国際: 鎖国・無神論・ネズミ講だけじゃなかった国を知るための45カ国 [Albania International: 45 Countries to Know the Country Which Is Not Only Isolation, Atheism, and Pyramid Scheme], Shakai hjooronsha, Tokio 2009; Shiba Riko, "Images of the Balkans in the Japanese Media of the Meiji

the midst of the Balkan Wars. The government of the Empire of Japan kept a close eye on the situation in the Balkans and sent diplomats and officers to the Balkans to gather information. Although there are already exhaustive papers by Imai Xhunko⁴⁶ and Uğur Altın on intelligence activities by the Ministry of Foreign Affairs and the Army of Japan during the Balkan War and their perceptions on the Balkans,⁴⁷ their research is limited to the period of the Balkan Wars.⁴⁸ Imperial

Period,” *Godišnjak za društvenu istoriju* 18, no.3 (2011), pp.7–16; Nakazawa Takuya, “Distant Mountains: Japanese Views on Albania and the Albanians during the Ottoman Rule,” *Albanian Studies* 7, no.2 (2024), pp.55–78.

⁴⁶ In this article, Japanese and other Eastern Asian names, including the author’s, are written in the Eastern Asian order, i.e., family name first and given name second. When transcribing Japanese characters, we adopt Dida’s style of transcription, neither the Hepburn nor kunrei-siki system. See Reko Dida, *Japonisht-Shqip fjalor themelor*, West Print, Tiranë 2012.

⁴⁷ Imai Xhunko 今井淳子, “Niçiro sensoo zen’ja kara dai’içixhi sekai taisen mae ni okeru nihon no barukan eno kanshin ni cuite 日露戦争前夜から第一次世界大戦前における日本のバルカンへの関心について [On the Japanese Interests toward the Balkans from the Eve of Russo-Japanese War until the First World War],” in *Nihon to too’oo shokoku no bunka koorjuu ni kansuru kisoteki kenkjuu: 1981 nen 9 gacu kokusai shinpoxiimu no hookokushuu* 日本と東欧諸国の文化交流に関する基礎的研究: 1981年9月国際シンポジウムの報告集 [Fundamental Studies on the Cultural Interaction between Japan and Eastern European Countries: Proceedings of International Symposium in September 1981], Too’ooshi kenkjuukai and Nihon too’oo kankei kenkjuukai, Kodaira 1982, pp.186–188; Uğur Altın, “20 seiki shotoo nihon ga toruko ni oite okonatta xhooho kacudoo: Kobajashi tecunosuke no xhirei 20世紀初頭日本がトルコに於いて行った情報活動: 小林哲之助の事例 [Japanese Intelligence Activities in Turkey at the Beginning of 20th Century: The Case of Kobajashi Tecunosuke],” *Research Journal of the Graduate School of Humanities and Human Sciences* 12 (2012), pp.67–84; *Id.*, “Japonya Genelkurmay Başkanlığı’nın Balkan Savaşlarında Yürüttüğü İstihbarat Faaliyetleri,” *Tarih Dergisi* 64 (2016), pp.101–123; *Id.*, “Sanboo honbu no xhoohoo kacudoo to nihon gaikoo: Barukan sensoo o çuushin ni 参謀本部の情報活動と日本外交: バルカン戦争を中心に [Intelligence Activities of the Japanese General Staff and Japanese Diplomacy in the Balkan Wars],” Ph. D. Diss., Graduate School of Humanities and Human Sciences, Hokkaido University, 2020.

⁴⁸ On Japan’s intelligence activities in İstanbul in the Ottoman period before the Balkan Wars, see also Misava Nobuo 三沢伸生, “20 seiki zenhan no isutanburu ni okeru nihon gunbu no kacudoo 20世紀前半のイスタンブルにおける日本軍部の活動 [Activities of the Japanese Military Authority in İstanbul during the First Half of the 20th Century],” *The Bulletin of Faculty of Sociology, Toyo University* 53, no.1 (2015), pp.21–34; *Id.*, “19 seiki macu no isutanburu ni okeru nihongun no xhoohoo kacudoo: Hukushima jasumasa ‘aoo nikki’ no shirjooteiki kaçi 19世紀末のイスタンブルにおける日本軍の情報活動: 福島安正『亜欧日記』の史料価値 [The Intelligence Activities of the Japanese Army in İstanbul at the End of the 19th Century: The Value of Hukushima Jasumasa’s Diary in Asia and Europe as a Primary Source],” *The Bulletin of Faculty of Sociology, Toyo University* 55, no.2 (2018), pp.33–47; Nagashima Iku 永島育, “Nihon rikugun

Japan's role in the Adriatic Question has also been studied by Boštjan Bertalanič,⁴⁹ but his focus is on Yugoslavia and not on Albania. In this paper, the author relies on these previous studies and expands upon these to describe how Japan and the Japanese viewed Albania and the Albanians in the 1910s.

1. Japan's diplomacy and intelligence activities about Albania

Periodha 1912-1921 karakterizohet nga një paqëndrueshmëri politike. Vendi vijon të jetë fushëbeteje dhe shumë teritore janë të pushtuar. Në rrjedhojë, qëndrimi në post i Ministrave të Arsimit është jetëshkurtër dhe vetë institucioni operon kryesisht me qarkore, rregullore e raporte. Akoma, shteti shqiptar nuk ka autoritet në të gjithë kufijtë territorialë. Në rrjedhojë, viti 1920 mund të quhet një pikë kthese në historinë e shtetformimit të Shqipërisë, ndërsa ligjet e viteve 1921 dhe 1922 janë të parët dokumente që referojnë një shkollë shqipe në shkallë vendi. Akoma, nëse në fillimet e shtetit shqiptar problem kemi vetëm hapjen e shkollave shqip, këto dy ligje referojnë struktura administrative dhe organizative të sistemit shkollor shqip, si dhe evokojnë qasjen mbi të cilën janë ndërtuar.

Ndryshimet në institucionet arsimore janë rrjedhojë e ndryshimeve në reformat dhe politikat arsimore, të cilat iniciohen dhe menaxhohen nga qeveria (Fan, 2020 :112). Ligjet e viteve 1921 dhe 1922 janë dy ligje që iniciohen dhe menaxhohen nga qeveria shqiptare. Synimi i tyre është njehsimi dhe modernizimi i sistemit arsimor. Për herë të parë në historinë e Shtetit shqiptar kemi një legjislacion të plotë për arsimin, të njëjtë dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar në shkallë vendi. Sistemi arsimor njehsohet si në qytet ashtu edhe në fshat, me detyra të qarta për të gjithë aktorët që kanë lidhje me arsimin.

Ligji për Organizimin Bazë të Arsimit përcaktonte ndarjen e shkollave në nivel fillor dhe të mesëm, përcaktonte strukturën dy-nivelëshe të arsimit fillor, si dhe specifikonte ndarjen gjinore në arsim. Ai vendoste arsimin si të detyrueshëm për fëmijët nga mosha 6 vjeç, megjithatë e konceptonte në mënyrë të ndryshme në qytet dhe fshat. Sistemi arsimor fillor është i detyrueshëm dhe falas, si për djemtë ashtu edhe për vajzat, por bazuar në ligj, vajzat dhe djemtë vazhdojnë të shihen si dy grupe të ndara: nuk referohen thjesht si fëmijë. Ligji njeh 'arsimin falas dhe të detyrueshëm', por nuk e përkufizon arsimin si një të drejtë e fëmijëve, por si detyrim ndaj shtetit.

Ligji i vitit 1922 synonte ndërtimin e një administrate funksionale për arsimin dhe përcaktonte dy zyre kryesore: Zyrën Teknike dhe Zyrën e Inspektoratit. Kjo ndarje reflektonte një përpjekje për profesionalizimin e arsimit dhe kontrollin institucional të tij në të gjitha nivelet. Ligji ofron një kuadër të qartë për inspektimin e shkollave, vlerësimin e mësimdhënësve dhe kontrollin mbi tekstet shkollore.

Fusha e zbatimit të ligjeve përfshin: organizimin qendror të ministrisë së arsimit, organizimin themelor të arsimit, ndjekjen e detyrueshme të shkollës, emërimin dhe largimin nga puna të mësuesve, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore, kushtet për hartimin e teksteve shkollore e aprovimin e shpërndarjen e tyre si dhe për bursat kombëtare.

Sa i takon Ministrisë së Arsimit, mund të thuhet se merr formën e një institucioni të mirë-organizuar, me detyra dhe funksione të qarta në të gjithë nivelet; e njëjta gjë mund të thuhet edhe për sistemin arsimor. Nuk mund të flitet ende për një filozofi të mirëfilltë arsimore, por flitet për politika shtetërore në shkallë vendi. Ligjet nuk artikulojnë një filozofi arsimore kombëtare, por mbështeten në një qasje praktike dhe administrative. Ato i japin përparësi krijimit të strukturave qendrore dhe disiplinimit të sistemit, në vend të vizionit për edukimin si e drejtë universale. Ndarja gjinore dhe mungesa e qasjes në zonat rurale janë pasqyra të kufizimeve strukturore.

Në krahasim me shtete si Serbia apo Greqia, ku arsimi u përdor si mjet për homogjenizimin kombëtar, ligjet shqiptare të kësaj periudhe shfaqin një tendencë për ndërtimin e strukturave institucionale, më shumë sesa për identitet kulturor të centralizuar. Ndarja gjinore dhe qasja e kufizuar në zonat rurale mbeten problematike. Ky është një aspekt ku Shqipëria ndjek një model të ngjashëm me shtetet e tjera ballkanike të kohës.

Ligjet e viteve 1921 dhe 1922 përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të arsimit publik në Shqipëri. Ato tregojnë përpjekjen e shtetit për të ndërtuar një sistem të centralizuar dhe të kontrolluar arsimor në një periudhë të brishtë politike. Mungesa e një filozofie arsimore kombëtare zëvendësohet nga një qasje praktike dhe administrative. Nevojitet më tej kërkim dhe përfshirje e literaturës së re për të kuptuar më mirë funksionin dhe ndikimin e këtyre ligjeve.

REFERENCA

- Assinger, P. (2020). Education and Training Politics in Europe: A Historical Analysis with Special Emphasis on Adult and Continuing Education. Studies on Education, Vol. 6. LIT Verlag GmbH & Co. KG Wien.
- Cranston, M. (1973). The ideology of Althusser. Problems of communism. March-April 1976, Vol. XXII, pp. 53-60.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit Shqiptar.
- Fan, G. (2020) Changes in Educational Institutions in China: 1978-2020. Analyses of Education Policies and Legal Texts from a National Perspective. In Fan, G. & Popkewitz, T. S. (Eds). *Handbook of Education Policy Studies: Values, Governance, Globalization, and Methodology*. Springer, Vol. 1, pp. 111-129.
- Instituti i Studimeve Marksiste-leniniste (1981). *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*. Botimi i dytë. Tiranë: Shtëpia Botuese “8 nëntori”.
- Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqipe: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912-1944* (The arduous path of Albanian school: issues, policies & activities in the field of education, 1912-1944). Tiranë: UET Press.
- Nathanaili, V. (2019). Politika, politika arsimore dhe vlera. Analizë bazuar në literaturë. Në Nathanaili, V. (Ed.) *Komercializimi i shkollimit*. Tiranë: Fondacioni “Henrietta Leavitt”, f. 161-176.
- Richardson, W. (2019). “Method in History of Education”. In Rury, J. L. & Tamura, E. H. (Eds.). *The Oxford Handbook of the History of Education*. New York: Oxford University Press, pp. 48-64.
- Hysi, G. (2007). Kongresi i Lushnjës dhe vendimet për rimëkëmbjen e shtetit kombëtar shqiptar. Statuti i Lushnjës. Në Omari L., Luarasi, A. (Eds.). *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*. Tiranë: Luarasi, ff. 329-335.

{ Aneks }

Ligjë “Mbi të nshkruemit e të ndjekunit të detyrshëm të shkollës”

Tiranë, 26 Nanduer 1921

Të nshkruemit në shkoll

Nye 1. Të nshkruemi të detyrshëm të nxanësve në shkollë parashikohet prej Nën 2 të Ligjës mbi organizimin themeluar t’Arsimit.

Nye 2. Për aplikimin e të nshkruemit të detyrshëm të fëmijëve në shkollë do të kujdeset Këshilli Shkollues i çdo Prefekturë a nënprefekturë tue u marrun vesht edhe me Bashkit e vendit. Në krahinat këtë detyrë e kryen krahinari në marëveshtje me Kryepleqt e me antaret e katundeve.

Nye 3. N’mes të Korrikut Kryetari i Bashkis asht i detyruem të përpilojë pas regjistrimit të bamun në Zyrë të Kadastrës një listë të djelmëve që kanë moshën e duhur për të ndjekun shkollën detyrisht e rregullisht. Në këtë listë do të dëftohen emrat e fëmijëve, ata të prindëve të tyre, lagja (mëhalla) e numri i shtëpive të tyre. Lista do të shpallet botënisht në ndërtesën e Bashkis e në vendet e tjera të dukëshme të qytetit, ku do të mbetet e varur deri në kohën e të hapunit të shkollave. Në krahinat listën e fëmijëve që do të ndjekin rregullisht shkollën e qet prej kadastrës të N.Prefekturës krahinari, po n’atë kohë, e me anë të kryepleqëve të antarëve të katundeve lajmon prindët e fëmijëve që ti dërgojn në shkollë, por sa qi të hapet kjo.

Nye 4. Bashkë me listën e sipërmendun Kryetari i Bashkis do të bajë edhe një shpallje në të cilën do t’i përmendi prindët të fëmijëve që janë shënue në listë detyrën qi kanë me dërgue fëmijët e tyre në shkollë e dënimi që do t’u vëhet në mos e bafshin detyrën e tyre. Gjithë deri 1 Shtatuer lista do t’u dërgohet edhe Drejtorëve të shkollave. Gjithashtu do të veprojë edhe Krahinari.

Nye 5. Drejtorët e Kryemësuesit e shkollave të qyteteve e të katundeve mbasi ti kenë nshkruem nxanësit deri më 10 të vjeshtës së parë, do të dërgojn drejt për së drejti Këshillit Shkollues të Prefekturës ose me anën e Krahinarit atij të Nën prefekturës, jo ma vonë se më 20 t’atij mueji, një kopje nga regjistri i nshkrimeve.

Nye 6. Këshilli Shkollues i Prefekturës a i Nën Prefekturës si të krahasojë regjistrat e nshkrimeve me listat e të detyrumve, thërret me anë të Kryetarit të Bashkis prindërit a mbrojtësit e fëmijëve qi s’janë shkruem për me i dërguem këta u nshkruem sa më parë e po nuk i paraqitën në krye të 5 ditëve do të quhen për tu gjobitë. Në krahinat këtë punë e ban krahinari me anë të Kryepleqëve të antarëve të katundeve.

Nye 7. Gjoba që do t’u jipet për mos nshkrimin e nxanësve të detyruem me ndjekun shkollat në kohën e caktueme do të jetë 20 deri 100 franga ari.

Nye 8. Gjobet e vumë do të mblidhen ndër qytete prej Kryetarit të Bashkis me anë të gjindarmëris e në krahina prej krahinarit gjith me anë të atij mjeti e do t’i dorëzohen Këshillit Shkollues e cila ka me i përdorur ato: 1) për meremetje

shkollash 2) për orendi shkollash 3) për libra e të tjera mjete mësimi për t'u dhanun nxanësvet vorfun e 4) për çmime nxansish të zellshëm.

Nye 9. Zyra e Kadastrës merr përgjegjësi të madhe për punët e rregjistrimit të nxanësvet që duhen të ndjekin detyrisht shkollën e në u vërtetofitë mungesa e detyrës së sajë në këtë punë duhet me u gjobitun prej Ministris kompetente. – Gjith atë përgjegjësi merr edhe Kryetari i Bashkis e Krahinar i çdo vendit.

Ligjë “Mbi pranimin e përdorimin e teksteve shkollore t’Arsimit filluer e të mesëm”

Tiranë, 26 Nanduer 1921

Artikulli 1. Në të gjitha shkollat qeveritare mashkullore a femërore si tekste shkollore do të përdoren vetëm ato të pranume e të pëlqyeme prej Ministri s’Arsimit botuer sipas kushteve të posht shënueme. Në të gjitha shkollat private si tekste shkollore do të përdoren vetëm ato qi të jenë paraqitë e pëlqyem prej Ministris së Arsimit. Këto tekste do të pëlqehen në qoftë se përgjigjen programës së parapëlqyeme prej Ministris së Arsimit.

Artikulli 2. Ministrija si të shpallë programen synthetike e analytike të shkollave do të hapë një konkurs për hartimin e teksteve shkollore sipas programës së shpallun e sipas instruksionesh të veçanta.

Artikulli 3. Porse Ministrija mund të zgjedhë një tekst të çfarëdo lande të mësimi filluer e të mesëm në gjuhë të huaj e ta vejë në konkurs përkthimin ase adaptimin e tij në gjuhë shqipe pas instruksionit të veçantë e pas systemës ligjore të shtetit.

Artikulli 4. Dorëshkrimet e teksteve të hartueme do t’i dërgohen Ministris mbrenda në një kohë të caktueme e si të kqyren prej një komisioni kompetent të veçantë do të pëlqehet një prej sish aji që do të jetë i hartuem ma mirë.

Artikulli 5. Ministrija do t’ija blejë autorit dorëshkrimin e pëlqyem me një çmim që i përket vlerës së tij e do t’ja dorëzojë shumën qi u caktue në konkurs, porsa të pranohet dorëshkrimi.

Artikulli 6. Libri atëherë bahet pasunija e Ministris s’Arsimit, e cila e shtyp me të prishunat e sajë edhe ngarkon ndonjë tregëtar, a libërtar, qi ta shesë me çmim të caktuem tue i lanë një fitim 10%.

Artikulli 7. Librari a tregëtari që i shet librin me një çmim ma të naltë se çmimin e caktuem do të dënohet me një gjobë 50 deri 300 franga ari e me burg 15 ditësh.

Artikulli 8. Libri i pëlqyem do të përdoret ndër shkollat për katër vjet rrjesht e pas kësajë kohe do të pranohet botimi i një tjetri ase do të përdoret po aji i përparëshmi tue marrë autori një shpërblim t’arsyeshëm.

Artikulli 9. Në vend të librit të pëlqyem nuk mund të përdoret libër tjetër ndër për shkolla. Mësuesit që përdorin libra të papëlqyeme prej Ministris së Arsimit

do të dënohen së parit me një të premë të rrogës mujore e për herë të dytë do të largohen për pesë muej nga puna.

Artikulli 10. Çmimi që do t'u jipet hartuesve apo përkthyesve të librave shkollorë caktohet si ma poshtë.

Fija (fleta) tipografike të teksteve tipografike d.m.th. 16 faqe, e librat të këndimit për çdo shkallë shkollore ashtu edhe ajo e teksteve të gjeografisë e të historisë e të arithmetikës do të paguhet me 80 franga ar.

Fija (fleta) tipografike e teksteve gjeometris do të paguhet nga 100 franga ari.

Fija (fleta) tipografike e teksteve të historisë së ditunisë së natyrës si edhe të librat fillosofike e pedagogjike do të paguhet nga 120 (njëqind e njëzet) franga ar.

Fija (fleta) e teksteve tjera si për muzikë vizatim për mësim të ndonji gjuhe të huaj etj. hyjnë në kategorinë a) dhe gramatikat e tjera shkrime e ksofare në kategorinë b).

Projekt-ligjë organike (AQSh. Fondi nr. 295, viti 1922, dosja nr. 12, fl. 9-13)

Mbi Administrimin Qendror të Ministrisë së Arsimit

Administrimi Qendror i Ministrisë së Arsimit, tash për tash, do të rregullohet me anën e dy zyrave: a) Zyra teknike b) Zyra e inspektorisë.

Zyra teknike përbëhet prej dy degëve të veçanta, nën drejtimin e një drejtorie të përgjithshme.

Drejtori i përgjithshëm është përgjegjës për të gjitha veprimet e ministrisë në punë teknike, administrative dhe financiare. Drejtori i Përgjithshëm është edhe këshilltar i Ministrit. Drejtorja e përgjithshme ka dy degë, A dhe B, të veçanta, me nga një shef dhe një sekretar.

Dega A, ka për detyrë, reformat e përmirësimet e programeve shkollore, mënyrën e vijimit të mësimëve, emërimet e pushimet e të gjithë mësuesve, zbaton të gjitha veprimet e lypuna me raportet e ardhuna prej inspektorisë. Dega B, ka për detyrë, rregullimin e jetëshkrimeve të mësuesve e të nëpunësve të arsimit, mban rregullisht punët financiare, si dhe statistikën arsimore. Për të dy degët e Drejtorisë së Përgjithshme do të ketë një kopist.

Zyra e inspektorisë përbëhet prej një inspektori të përgjithshëm dhe një sekretari. Kjo zyrë shqyrton raportet teknike që vijnë nga inspektorët e qarqeve dhe i kumton, nevojat, Drejtorisë së përgjithshme. Inspektori i përgjithshëm, përveç hetimeve që mund të bëjë mbas një urdhri të Ministrisë, ka për detyrë edhe inspektimin e të gjitha shkollave dy herë në vit.

Ministria ka një shef *de bureau*, i cili ka për detyrë rregullimin e bibliotekës, të protokollit, të arkivës dhe të magazinës. Kjo zyrë ka një protokollist, një arkivist dhe një magazinier.

Detyrat e secilës zyrë do të caktohen hollësisht në një rregullore të veçantë.

**GRUEJA SHQYPTARE - RËNDËSIA E BOTIMIT TË NJË REVISTE ME
FOKUS GRUAN
ALBANIAN WOMAN – THE SIGNIFICANCE OF PUBLISHING A
MAGAZINE FOCUSED ON WOMEN**

Dr. LORETA LOLI

Universiteti i Tiranës

loreta.loli@unitir.edu.al

Abstract

Pedagogical, cultural and literary magazines inspired and directed by women are rare events in the history of Albanian retrospective periodical, which has been dominated by the male voice. Reflecting on the new conditions, of a first modernity that has begun, these intellectual initiatives have national importance.

The editorial journey started by Mrs. Parashqevi Qiriazi, with “Yll'i Mëngjezit” (1917), published in Boston, USA, would be followed at the end of 1920-s, this time within the country, by “Grueja Shqyptare”. The magazine, as the title suggests, focuses on the figure of women. Dictated by the new century, this woman must first transform herself to contribute to the development of society and the country. In this initiative full of challenges and responsibilities, she will not be alone. She will be accompanied by prominent Franciscan personalities, who will help her as co-organizers in this undertaking, not only with published articles in the magazine's pages, but also with the technical realization, by printing the periodical almost free of charge in their printing house (Franciscan Press).

Our paper will highlight the journalistic and literary communications through various genres during the nine issues of “Grueja Shqyptare”, which was published in Shkodra from November 1920 to July 1921, keeping the modernization of Albanian women as its main theme.

Key words: “Grueja Shqyptare”, the retrospective periodical, Shaqe (Marie) Çoba, Gjergj Fishta, Lazër Shantoja, etc.

Hyrje

Revistat shoqërore, pedagogjike, kulturore, letrare të frymëzuara dhe të drejtuara nga vetë gratë janë ngjarje të rralla në historikun e periodikut retrospektiv shqiptar, i cili është dominuar nga zëri i fortë mashkullor. Në vazhden e reflektimit të kushteve të reja historiko-sociale, të një moderniteti të parë që kishte nisur në vend, pas fitimit të Pavarësisë, të këtilla nisma intelektuale marrin rëndësi kombëtare.

Rrugëtimi editorial femëror i çelur nga Parashqevi Dako Qiriazi, me botimin në Boston të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të së përkohshmes “Yll’ i mëngjezit” (1917), veprën e saj më të madhe, siç do ta vlerësonte Kristo Dakua në shkrimin mbi kthimin në atdhe të editores, znj. Qiriazi¹⁰², do të ndiqet në nëntorin e 1920-ës, këtë radhë brenda Shqipërisë, nga botimi i një tjetër periodiku të rëndësishëm, nga “Grueja shqiptare”. Revista e thotë që në titull se në fokus do të ketë gruan. Gruan shqiptare të shekullit XX.

Si organ i komitetit “Gruaja Shqiptare”, themeluar më 3 gusht 1920 në Shkodër nga Marie (Shaqe) Çoba, revista kishte ndër qëllimet e veta dhe grumbullimin e ndihmave për forcat shqiptare që luftonin kundër serbo-malazezëve (Lufta e Koplikut). Ndaj, për ta informuar publikun për punën që bënte ky komitet faqet e saj shërbyen si pasqyra analitike mbi zërat e ndihmave që shkonin për trupat shqiptare në terren, ndihmat që u dërgoheshin qendrave mjekësore, apo ndryshe smuetoireve, njerëzve në nevojë etj.

Shekulli i ri i kërkonte gruas shqiptare që të transformonte përmes arsimit e kulturës mësëpari veten, për të mundur më pas të ndikonte në zhvillimin e modernizimit të shoqërisë. Programi i revistës shpallet nga Drejtuesit e saj në faqen e parë të numrit të parë (nëntor 1920), dhe përmbledhtazi mund të jepet kështu: *Përparimi i grues shqiptare në gjytetëri*.

Për ta arritur qëllimin gruaja do të shihet në të gjitha dimensionet e saj: si qenie njerëzore, si bashkëshorte, si nënë, vajzë, qytetare shqiptare. Veçanërisht theksi do të vihet te roli i nënës dhe i bashkëshortes: “Kombi shqypetar, po desht për njëmend me u ndërtue Shtet m’vedi e me dalë vereverte një shoqnië e gjytetnueme, lypet domosdo e para ç’do pune tjetër, qi ai t’ja vejë të gjithë menden e vet përparimit e gjytetnimit të FAMILJES: pse, tue kenë se Familja asht themeli i parë i shoqëriës njerëzore, njashtu Përparimi dhe qytetërimi i brezit të ri (fëmijëve) e ka të domosdoshme qe edhe prindërit e tij të jenë të qytetëruar.”¹⁰³

Prandaj, komiteti “Grueja Shqiptare”, “tuj marrë parasysh të metat e mdha të Familjes shqiptare në pikpame të kulturës e të gjytetniës, e tuj marrë me kujdes, se mbi grue randon ma s’fortit edukata e Familjes, ka vendue me botue muej për

¹⁰² Christo A. Dako, *Yll’i mëngjezit*, nr.12 (1920):331

¹⁰³ “Programi i Jonë”, *Grueja Shqiptare*, nr.1, (1920):1

muej një të përkohshme, me qëllim që me i nimue grues shqiptare në përparim, këtë vepër e përkohshmja ka me u orvatë t'a zhdrivillojë me botime literatyre: me tregime mbi të drejta, detyrë e rangë që ma për s'afërmi i perkasin grues: me lajme, artikuj etr. Shpnesojmë, se s'ka me pasë Familje në Shqypnië, ku të dihet me kndue e me shkruie, që mos të pajtohet në përkoshme t'onë. Prej anës s'onë na kemi me u mundue t'a bajmë përkoshmen sa ma të pelqyeshme e t'interensatshme".¹⁰⁴

Angazhimi i shpallur nga Drejtimi i revistës, pas të cilit, sipas bibliografëve, fshihet Gjergj Fishta¹⁰⁵, realizohet mjaft mirë gjatë të nëntë numrave të së përkohshmes, duke sjellë që nga nëntori 1920 deri në korrik 1921 materiale të larmishme të natyrave pedagogjike, psikologjike, letrare, muzikore, kulturore, gastronominë, edukatën shtëpiake, kujdesin personal që duhet të tregojë vajza, etj.

Ajo që bie në sy është fakti se në këtë sipërmarrje me shumë vlerë ndërtohen komunikime dinamike mes grave shqiptare dhe emrave të shquar të kulturës kombëtare, ku vendin e nderit e mbajnë etërit françeskanë të prirë nga Gjergj Fishta dhe Lazër Shantoja. Të dy autorët nuk dalin drejtpërdrejt me emrat e tyre, por përmes pseudonimeve të ndryshme, ku për Fishtën veçojmë sipas linjës kronologjike ato të: *Drejtimi-t*, - *u*, *Gegë Toska*, *Safo.*, dhe *X*, ndërsa për L. Shantojën: *Athanas Ziler* dhe *Omega*.

Të njëjtën formë komunikimi me lexuesin, sa i takon veshjes së identitetit autorial zbaton edhe autorja grua. As kjo nuk identifikohet, por vjen përmes pseudonimeve. Si "një grue Shkodrane", "Nji Pjestare e Komitetit", "Minerva" etj. Përrjashtim bën rasti i Parashqevi Qiriazi, në shkrimin që i dërgon drejtorisë të së përkohëshmes mbi Programin e Shoqnis së zonjavet "Grueja Shqiptare"¹⁰⁶ në qytet të Tiranës, një shkrim ky i natyrës informuese. Duke e përgëzuar nismën që morën gratë shkodrane me botimin e periodikut të tyre, i cili po shërben *de facto* si model edhe për gratë e tjera, - për shembull, për gratë vlonjate: edhe këto njësoj si të parat nisën në qytetin e tyre botimin e revistës të quajtur "Shpresa Kombtare"¹⁰⁷, P.Qiriazi i njofton koleget e Shkodrës për zgjerimin e shoqërisë "Grueja Shqiptare" edhe në qytetin e Tiranës: "Me anën të këtyre pak radhë po vinj t'u lajmëronj se më 27 të Dimërorit 1920 u fillua këtu në Tiranë Shoqëria e Zonjavet 'Grueja Shqiptare'". Vijon me pasqyrimin e detajuar mbi organizimin e shoqërisë më të re të themeluar në Tiranë, me emrat e përveçëm të kryetareve të nderit, si: zonja Servet Bej Libohova e zonja Fuad Bej Toptani, kryetares

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Gjergj Fishta, *Publicistika. Tash, që është bërë Shqipnija, duhen përbërë shqiptarët*, (Shkodër: Botimet Françeskane, 2020) 1017-1018

¹⁰⁶ Parashqevi Qiriazi, "Programi i Shoqnis së zonjavet GRUEJA SHQYPTARE në gjytet të Tiranës.", *Grueja Shqiptare*, nr.5 (Mars 1921):34

¹⁰⁷ Ibid, :41

vepruese, nënkryetareve, sekretares, arkëtares e ekonomisteve, plot 24 gra pjesë të stafit dhe e përfundon fjalën me dëshirën ambicioze që nisma të shtrihet në të gjitha qytetet shqiptare, ku kryeparitë të vendosin komunikime të përbashkëta me njëra-tjetrën, duke krijuar kështu një rrjet të fortë ndërveprues për t'u dhënë zgjidhje problemeve që u përkasin grave shqiptare në kohën e re.

Metodologjia e punës:

Punimi ynë, në përgjithësi, ka karakter përshkrues dhe interpretues. U ndalëm në kontekstin historik të botimit të revistës “Grueja shqiptare” sepse kjo është revista e krijuar nga komiteti “Gruaja shqiptare” Shkodër, me drejtore Marie (Shaqe) Çobën, që si lexues të vetin imediat projekton gruan dhe vajzën shkodrane. Me një të tillë veçori cilësore në tipologjinë e shtypit retrospektiv shqiptar puna jonë u përqëndrua në hulumtimin e artikujve përgjatë 9 numrave të revistës ku objekte dhe subjekte janë gratë dhe roli i tyre në shoqërinë e re shqiptare. Mbi tekstet e natyrës letrare, - katër krijimet poetike që sollën autorët Gjergj Fishta dhe Lazër Shantoja, të cilët u frymëzuan dhe kënduan për gruan e vajzën shqiptare, aplikua analizën tekstore dhe komunikimin lexues-tekst.

Tekstet letrare në revistë

Tekstet letrare të revista “Grueja Shqiptare” do t'i sjellin Gjergj Fishta dhe Lazër Shantoja të cilët, përmes lëvrimit të disa zhanreve, - nga madrigali, poezia dhe poema e gjatë deri te shkrimi anekdotik i japin gruas shqiptare edhe prekje shpirtërore. Poeti i *Lahutës*, me figuracionin e pasur në metaforë, personifikim e krahasim spikat fisnikërinë, bukurinë dhe hijeshinë trupore të vashës, ftyra e së cilës i ngjan me dritën e agimit e fjala me një fllad të parrizit, sa gjithë natyra përjeton dashuri:

*Kuer t'më bjerë ajo ktij vendit;
Nën kunorë të Bukuriës,
Shpërthejnë lulet prej gazmendit,
Kndojën bylbylat n'vapë t'dashtniës,*¹⁰⁸

(Shkëputur nga poezia pesëstrofëshe me titull “Sofija”, e cila shoqërohet nga sqarimi autorial: “Prej një duke dramatike të pabotuar më parë”. Poezia është shkruar me pseudonimin “Safo.”)

Nën të njëjtin pseudonim Fishta do të vijë në numrin pasardhës të revistës me pjesën dramatike “Deka e Bylbylit”. Titulli shoqërohet përsëri nga shënimi i

¹⁰⁸ “Safo.” (Gjergj Fishta), “Sofija”, *Grueja Shqiptare*, nr.3 (Kallnuer 1921): 21-22

autorit mbi botimin për herë të parë të tekstit: (Prej një duket dramatike të pabotueme). Ambienti ku zhvillohet subjekti është thellësisht lirik: livadhi dhe bregu i lumit, siç janë të tilla, - lirike, personazhet e marra nga bota e folklorit shqiptar: *Vallja*, *Lulet e Maleve* dhe *Lulet e Fushave*. Zhytur në një atmosferë përrallore, mes lojës shprehëse të personifikimit, metaforës, alegorisë dhe simbolit pjesa hapet me fjalët e personazhit të *Valles*, e cila tregon për kalimin e dimrit dhe ardhjen e ditëve të bukura të pranverës, që premtojnë dashuri. Këtu gjuha e Valles është pasqyruese.

Ndërsa te personazhet e tjera (*Lulet e Maleve*, *Lulet e Fushave*) gjuha bëhet shprehëse dhe figuruese. Dialogu që zhvillojnë *Lulet* mes vedit tregon për dhimbjen e bylbylit, heroit tragjik.

Lulet e Malevet

*Páshi voësën, heu! t'agimit!
Páshi at erë qi keni n'gji!
Deh! na thoni ç'farë idhnimit
Na i ká rá bylbylit t'ri?*

Lulet e Fushavet

*Paska rritë bylbyli 'i lule,
Më lot t'syevet tue e flladitun:
Tash, po thonë si 'i dorë - gerbule
Ja ká kputë edhé grabitun!*

Ritmi i poemës përftohet nga ndërthurja e përshkrimit me dialogun, i cili herë vjen në formën e pyetje-përgjigjeve që personazhet bëjnë me njëra-tjetrën, herë të tjera me ligjërime dëshirash e mallkimesh të hiperbolizuara, pjesë e dukurisë së oralitetit të poetikës fishtiane. Pjesa nis e qetë (*Vallja rrëfen*), për t'u ngritur në lartësi emocionale, kur *Lulet* pyesin, dëshirojnë e lëshojnë mallkime për fatin e heroit të dashur, por të pafat, bilbilit.

Vallja

*Gzon tânë natyra
Gzon toka e qelli;
Mâ i bukur dielli
Mbí dhé shkelxen.
Nper fllad të erës
Sod zogu i verës
Kangët po i pëlqen*

Lulet e Malevet

*Ajo dorë -ó grabitqare
Qi bylbylin paska idhnue,
Ajo kurr mos raftë m'zamare!
Ajo u thaftë si gêm në ftue!*

Lulet e Fushavet

*Porsi krandja ajo u shtangoftë!
Mbí tē bora raftë e e mloftë!
Mbí tē shiu raftë edh' e zbloftë!
Raftë m'tē breshni edhe e coptoftë!*

Nga ana metrike ky ndryshim mund të shihet në përdorimin e llojit të strofave. Në përshkrim/rrëfim (Fjalët e Valles) është përdorur strofa gjashtë dhe shtatë vargëshe, në dialogë (Ligjërimi mes Luleve) strofat katërshe.

Të tana Lulet s'bashkut

*Mbasi bjeshkve dêe âsh bora
E blerue kan male e zalle,
Eni t'kapna dora-dora
E t'a thona ktû një valle
T'thona 'i valle tue kendue,
Mal e fushë t'bijme me jehue*

Historia e dashurisë së bylbylit me lulen e dashur, që fati nuk i la të gëzoheshin në dashuri, sjell tragjedi: vdekje për lulen (vajzën) dhe vetëvrasje për bilbilin (djalin). Nuk ndihmojnë për ta shmangur tragjedinë e dyfishtë as fjalët ngushëlluese as ftesat përkëdhelëse që Lulet ia bëjnë bilbilit.

Lulet e Fushavet

*Hec me në, bylbyl, nder djerre
Kú të njoma lule shtiëllen:
Nji qi t'duesh nder to ti merre:
Po t'a falim Drandofillen*

Vallja

*Shueni kangë e shueni valle,
Shueni valle për me kja;
Se nder në një kob ka ra:
Thonë ka dekë Bylbyli sot.
N'ato hije e n'ato zalle,
Tuj vajtue naten e ditën,
Per një 'at lule q' i a grabiten,
Zëmra t' mjerit ju shkrië n' lot!*

Një profil të veçantë kanë dy krijimet poetike të Lazër Shantojës, tek i cili mbizotëron fryma liriko-tragjike. Me “Besë deri në vorr!...” (Madrigale), shkruar me pseudonimin *Athanas Ziler*, në nr.1 dhe “Vorr i harruem!...”, me pseudonimin *Omega*, në nr.7, maj 1921, L.Shantoja sjell gjendje të rënduara shpirtërore, ku flitet për vdekjen. Në poezinë e parë trajtohet tema e besnikërisë mes dy të dashuruarve. Vasha e re, pasi dialogon me hijen që paralajmëron vdekjen e të dashurit të zemrës, e mban besën që i dha atij duke mos e braktisur deri në fund të jetës. Në poemën e dytë, të ndërtuar me shtatë strofa të gjata, përshkrimi i natyrës flet përmes metaforës mbresëlënëse që shkakton vdekja e vajzës në moshë fare të re, të cilën uni lirik na e paraqet vetëm me imazhin e varrit dhe të atmosferës pikëlluese. Të dyja poezitë i bashkon tema e vdekjes së parakohshme të të rinjve, e kjo, me sa duket, për të dhënë idenë se jeta dhe vdekja janë njësoj normale për njeriun. Pra, edhe për vajzën e gruan shqiptare.

Gruaja si autore shkrimesh

Pseudonimi “një grue Shkodrane” dhe, me shumë gjasa edhe “Minerva”, i përkasin Shaqe (Marie) Çobës, drejtore e revistës, e cila bëhet më shumë prezente në tri numrat e fundit të periodikut. Përmendim këtu shkrimet si: “Familja”, “Feminizmi” e “Zakonet t’ona”. I dyti bëhet shkas për t’u botuar, sepse, në këtë kohë, siç shprehet autorja, fletoret e ndryshme shqiptare kanë filluar të flasin e zhvillojnë temën e feminizmit, “e tuj kenë kjo një landë tepër e haptë e tepër dilikate, xuenë shkrimtarët t’onë me hië ndër polemikë shoq me shoq. Ne grania, deri sot, kemi ndejë krejtë dore – jashtë e pa ba za në uzdajë se burrnia, tue e rrahë e tue e shoshitë ndermjet të vedit çashtjen e feminizmit, ka për të marue, nemostjetër prej marrjet, me i njoftë e me i pranue të drejtat t’ona; por mjerisht jemi tuj drashtë se shumica e burrniës nene nuk ka mrriet me i kuptue a ndoshta nuk don me i kuptue kto të drejta, të cillat përkundra na rrjedhin fillë prej natyrës e prandej prej ligjës së Zotit”.

Falë formimit juridik dhe kulturës së admirueshme (Shaqe (Marie) Çoba është ndoshta e para grua shqiptare që ndoqi universitetin për “Shkenca Politike”)¹⁰⁹, në ligjërimin e saj dominon logjika dhe forca e argumentit, duke e veçuar shkrimin në fjalë për diturinë dhe autoritetin e gruas së kulturuar¹¹⁰. Natyrisht, të flasësh këtu për ndërgjegjësim në masë të gruas shqiptare është ende herët, por shkrime si ky i zonjës Çoba dhe simotrave të saj më vonë, bashkë me figura të tjera kombëtare: - “Jemi të gëzuem shumë tue pa dy organe femnash në Shqypni, pse prej kësaj pune ngjallen shpresë të mdha se faktori kryekreje (femna) i zhvillimit të komit t’onë ka xanë rrugën e mbarë të zgjimit e të përparimit”¹¹¹, - do të shprehej entuziast Karl Gurakuqi nga fletorja “Agimi” në mars të 1921-it, teksa përshëndeste botimet e revistave të grave shqiptare në Shkodër e Vlorë, është hapi cilësor që shënjon fillimet e viteve ‘20 të shekullit të shkuar, hapa që do të intesifikohen më shumë përgjatë dy dhjetëvjetëshave pasues me botimet e organeve të tjera periodike dhe, sidomos, me debatin zotërues që do të bëhet në shtyp për Gruan shqiptare (përmendim revistat “Shqiptarka”, “Minerva” etj., artikujt e botimet e Lumo Skëndos, të Nebil e Ikbal Çikës, të Mehmet Konicës, Branko Merxhanit, Vangjel Koçës etj.,).

Në shkrimin me titull “Zakonet t’ona”, shkrimi më i gjatë i autores Çoba (4 faqe të plota reviste), botuar në numrin 8, qershor 1921, pasi vë në dukje zhvillimet pozitive dhe me frymë përparimtare që kanë ndodhur në qytetin e Shkodrës, ku dalë – kadalë disa zakone të vjetra e shumë të prapambetura janë lënë mënjanë nga gratë e qytetit, ajo tërheq vëmendjen në disa zakone të tjera të papëlqyeshme të cilat, për fat të keq, vijojnë ende të zbatohen si dhe në disa fenomene shoqërore në të cilat gruaja është viktimë. Për shembull, sjellja e gruas shkodrane ditën më fatlume të jetës së saj, siç do duhej të qe dita e saj e dasmës. Edhe pse veshja që mban është e njëjtë me atë të gruas perëndimore (e quan gruan shkodrane me veshje frënge), kjo është veçse një fasadë. Në kundërshti me të, ajo, nusja shkodrane, shihet si “një copë dru, që rri me sytë për dhe”, “pa mujt me

¹⁰⁹ Sipas Albert Vataj: “Shaqe Marie Çoba, shqiptarja e parë që priu gratë në luftën për liri dhe të drejta”, botuar në *Kult plus*, 15 qershor 2020

¹¹⁰ Shih gjithashtu Ardian Ndreca. “Për një histori të lëvizjes feminist në Shqipëri”, *Shëzjat*, janar-qershor (2021)

¹¹¹ **“Grueja shqyptare, - Shpresa Komtare.** Komiteti i Gravet të Shkodrës “Grueja Shqyptare” qysh në muajt të Nandorit të vj. të k. boton një të përkohshme të përmuejshme me të njajtin titull. Ashtu edhe Komiteti i Gravet të Vlonës “Shpresa Komtare” nisi të botojë organin e saj me titull t’emnit të tij. – Jemi të gëzuem shumë tue pa dy organe femnash në Shqypni, pse prej kësaj pune ngjallen shpresë të mdha se faktori kryekreje (femna) i zhvillimit të komit t’onë ka xanë rrugën e mbarë të zgjimit e të përparimit”. *Criticus*.

shqyptue asnji gjys fjalet, a thue se nji turp i madh randon mbi te për at kunor marteset që ka lidhun me fatin e vet”, kur do duhej “qi kjo veshë e saj, qi në vetveti përfytyron çiviltetin e soçëm, lyp liriën e granies, at lirië që shkëlخن ndër vendet e gjytetnueme, at lirie, po tham, në vërtyt të cillës grueja ka të drejtë me diftue çiltas ndiesinat e zemrës së vet pa kenë e detyrueme me u shtruve do zakoneve, qi, tue kenë në kundërshtim me ligjet e natyrës, e përulin, e peqasin dinjitetin e sajë”.

Një sjellje kësisoj autorja e shpjegon me natyrën konservative që ka populli shqiptar, tipar ky që i është vënë në dukje veçanërisht nga të huajt.

Aftësia në komunikimin publicistik, falë kurajos intelektuale dhe të thënurit të mendimeve pa doreza, e ndihmuar edhe nga ndërtimet foljore në vetën e parë, të tipit: po tham, po dëftej etj., që i japin afërsi dhe forcë ligjërit, por, veçmas njohuritë, që nuk i mungojnë në asnjë rast, shpesh të përdorura nën tisin e ironisë, e bëjnë për vete lexuesin, ndërsa stilin e autores, të veçantë, të drejtpërdrejtë dhe shumë familjar. Për të tilla kartakteristika, gjykojmë se teksti i sipërpërmendur mund të qëndrojë fare mirë në një dialogim të barabartë me publicistikën e Fishtës.

Fill pas “Zakoneve t’ona” vjen shkrimi me titull “E Përkohëshmjia e ynë”, i cili paralajmëron mbylljen e afërt të revistës për arsye ekonomike. Edhe pse nuk ka një emër apo pseudonim të poshtëshënuar, nga toni i përdorur duket se pas tij fshihet një grua, e me shumë gjasa, Një Grua Shkodrane. Në mënyrë të veçantë u jepen falenderimet e mirënjohja Frenit Françiskanë, të cilët e ndihmuan periodikun për nëntë muaj në çdo numër si teknikisht, duke e shtypur thuajse pa pagesë në shtypshkronjën e tyre, si në përmbajtje dhe vijën editoriale, me botime tekstesh letrare e publicistike.

Sado pra që revistës nuk i mungoi përkrahja e burrave të kulturuar të kombit, të cilët bashkëluftuan për emancipimin e vajzës, të motrës, gruas e nënës shqiptare, ndihet zhgënjimi në fjalët që përcjellin njoftimin e trishtë për mosmbështetjen e nevojshme financiare nga burrat e Shkodrës për ta mbajtur më gjatë në jetë këtë nismë intelektuale. “Na e diem mirëfillt se Shkodra nuk asht aq e vorfën sa mos me mujtë me e majtë në kamë nji të Përkoshme të vogël të Granies; nji të Përkoshme qi na, rrejtuna ndër ditët e para prej premtimeve të bukura qi na u dhanë prej disa atdhetarve, shpresojshim në pak kohë, me e rritë e me e përmirsue m’nji mendyrë kaq të pëlqyeshme sa me kenë e këndueme e e çmueme jo vetëm në Shkodër, por nder të gjitha viset e Shqypnies.”

Jetëgjatësia e një periodiku, veçanërisht në një mjedis të ashpër sikundër qe ai shqiptar në vitet ‘20 të shekullit që kaloi, ishte problem i zakonshëm, nga i cili kush më shpejt e kush më vonë nuk ia doli dot të mbijetojë. Ajo çfarë ka rëndësi dhe që mbetet është përmbajtja dhe zërat që i dhanë frymë periodikut. Dhe “Grueja Shqyptare” (pashmangshëm shoqëruar nga simbolika ironike e të qenurit grua: - jetoj veç 9 muaj!), ndikoi përmes shembujve konkretë në qytetërimin dhe modernizimin e Gruas dhe të Familjes shqiptare. Sepse në fund, Ajo - Femna, për

ta risjellë me fjalët e profesor Karl Gurakuqit, është faktori kryekreje i zhvillimit të komit t'onë që ka xanë rrugën e mbarë të zgjimit e të përparimit.

Konkluzione:

Edhe pse nuk kanë munguar studime/artikuj mbi prurjet e shumta të periodikut retrospektiv shqiptar, përsëri në të, sidomos në shtypin e para 1930-ës, gjenden burime interesante të pavërejtura, veçanërisht për kontributin që ka dhënë gruaja shqiptare në zhvillimin dhe kulturimin e shoqërisë sonë. Në punim u ndalëm në rastin e revistës “Grueja shqiptare”, të botuar në qytetin e Shkodrës nga nëntori 1920 deri më korrik 1921, sepse kjo revistë del si organ i Komitetit “Grueja Shqiptare” Shkodër, me drejtuese Marie (Shaqe) Çobën dhe si lexues të vetin imediat projekton gruan dhe vajzën shkodrane, si edhe, më gjerë atë shqiptare.

Rrugëtimi editorial i çelur nga Parashqevi Dako Qiriazi, me “Yllin e mëngjezit” (1917), Boston, SHBA, ndiqet në fundin e vitit 1920, brenda territorit shqiptar, nga “Grueja shqiptare” Shkodër, e cila, siç e shpreh që në titull, vë në fokus figurën e gruas. Gjatë 9 numrave që komunikuan me publikun u trajtuan probleme sociale të gruas shkodrane, si edhe, më gjerësisht probleme të feminizmit. Diktuar nga shekulli i ri kjo grua duhej të transformonte së pari veten që të mundej të kontribuonte për zhvillimin e shoqërisë dhe të vendit.

Nga analiza e shkrimeve na rezultoi se bashkëpunimi mes autorëve françeskanë dhe autoreve gra, pjesë të Komitetit “Grueja Shqiptare”, është i madh. Fretënit françeskanë, ku dallon Gjergj Fishta, i cili sjell shkrime të natyrave të ndryshme, jo vetëm letrare, janë një mbështetje e madhe, jetike për jetëgjatësinë e revistës. Françeskanët e ndihën revistën jo vetëm nga ana e realizimit teknik, duke e shtypur në shtypshkronjën e tyre, por edhe me artikuj të shumtë të natyrave sociale, kulturore dhe letrare. Nuk mund të dilet me një bilanc të qartë se sa prej autorëve janë burra dhe sa gra, sepse jo pak shkrime u botuan me pseudonime, një pjesë të padëshifruara ende¹¹². Megjithatë ajo që na rezultoi nga analiza është fakti se autorja grua debutoi në shkrimet e natyrës sociale, qytetare, kulturore, me të cilat diskutoi mbi probleme të femizimit, një temë që fillon të shtrohet dhe të intesifikohet më fort në vitet pasardhëse. Ndërsa autorët burra mbajtën ekskluzivisht pjesën letrare (edhe pse e pakët në sasi), ku u frymëzuan nga figura e gruas dhe e vashës shqiptare.

Revista “Gruaja Shqiptare” shënon një nismë intelektuale që kontriboi për zhvillimin dhe qytetërimin e gruas shqiptare në kushtet e një kohe të re të një

¹¹² Maks Gjinaaj, *100 vjet botime Françeskane*, (Shkodër: Botime Françeskane, 2016)

shekulli të ri. Në pikëpamje të historisë së shtypit shqiptar restrospektiv, padyshim ajo ka një vlerë të veçantë sepse shënon hapat e parë të gruas shqiptare në këtë medium komunikimi publik.

Bibliografia:

- Çoba, Marie (Shaqe). “Familja”, *Grueja Shqyptare*, nr.3 (kallnuer 1921, vjeti I)
- Çoba, Marie (Shaqe). “Zakonet t’ona”, *Grueja Shqyptare*, nr.8 (qershuer 1921)
- Çoba, Marie (Shaqe). “E përkohshëmja e ynë”, *Grueja Shqyptare*, nr.8 (qershuer 1921)
- Çoba, Marie (Shaqe). “Mirënjoftja”, *Grueja Shqyptare*, nr.9 (korrik 1921)
- Dako, A. Christo. “Editor’ e Yllit Mëngjezit u Nis Për Në Shqipëri”, *Yll’ i mëngjezit*, nr.12 (shtator 1920)
- Gjinaj, Maks. *100 vjet botime Françeskane*, Shkodër: Botime Françeskane, 2016
- Fishta, Gjergj. “Programi i jonë”, *Grueja Shqyptare*, nr.1 (nanduer 1920)
- Fishta, Gjergj. “Sofija”, *Grueja Shqyptare*, nr.3 (kallnuer 1921)
- Fishta, Gjergj. “Deka e Bylbylit”, *Grueja Shqyptare*, nr.4 (fruer 1921)
- Fishta, Gjergj. *Publicistika. Tash, që është bërë Shqipëria, duhet për të shqiptarët*, Shkodër: Botimet Françeskane, 2020
- Gurakuqi, Karl. “Grueja shqyptare, - Shpresa Komtare”, *Agimi*, (mars 1921)
- Ndreca, Ardian. “Për një histori të lëvizjes feminist në Shqipëri”, *Shëjzat*, (janar-qershor 2021)
- Shantoja, Lazër. “Besë derë në vorr!...”, *Grueja Shqyptare*, nr.3, (kallnuer 1921)
- Shantoja, Lazër. “Vorr i harruem!...”, *Grueja Shqyptare*, nr.7, (maj 1921)
- Vataj, Albert. “Shaqe Marie Çoba, shqiptarja e parë që priu gratë në luftën për liri dhe të drejta”, *Kult plus*, (15 qershor 2020)

Studime Albanologjike

1/2025

Botimi i parë 2025

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit

E-mail: studimealbanologjike@fhf.edu.al

www.studimealbanologjike.edu.al

© copyright Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit
të Tiranës

ISSN 2305-3828

ISSN online 2959-9695

**STUDIME
ALBANOLOGJIKE**

1/2025

ISSN 2305-3828
ISSN online 2959-9695